

GAZETA SHQIPTARE



Kryeredaktor: Erl MURATI
Zv/kryeredaktore - Rezarta DELISULA
Tel:(04)2359-104, Fax:(04) 2359-116 E-mail:gazetashqiptare@hotmail.com



Viti XXVI - Nr. 7782 E shtunë 13 Prill 2019 Çmimi, 50 lekë (1.5 euro)

Dje në **'Deutsche Welle'**

Kancelarja gjermane, Angela Merkel dhe presidenti francez, Emmanuel Macron kanë ftuar liderët e Ballkanit të marrin pjesë në Berlin në një konferencë. Në takim...

Vijon në faqen 20

Nga ANILA SHUKA

Gjermania: Ballkani është detyrë e Evropës



Opinion i **Ditës**

Edhe pse jemi në një tranzicion të stërzgjat, që po i dëshpëron përditë shqiptarët, të cilët prej mungesës së shpresës po gjejnë si rrugë shpëtimi braktisjen e vendit...

Vijon në faqen 21

Nga SHEZAI RROKAJ

Koha për të folur shqip!?



Meta: Të krijojmë klimë dialogu politik

S'do ketë çadër, detajet e protestës. Basha, Ramës: S'ka zgjedhje pa opozitë

Ambasada e SHBA, thirrje qytetarëve: Evitoni kalimin para Kryeministrisë dhe para parlamentit

Nga VALENTINA MADANI

Opozita do të protestojë sërish sot para Kryeministrisë me kërkesën për largimin e Edi Ramës. Ndryshe nga herët e tjera qytetarët do të mblidhen para Kryeministrisë në orën 18:00. Pas 2 muajsh protesta masive...

Në faqet 2-3

PROKURORIA "MERR" TROJE, SHTEPI, VILA DHE 9 MAKINA TE FAMILJES MURATAJ

SEKUESTRO PASURIVE TE GRABITESIT TE RINASIT

Gjendet celulari i viktimës së grabitjes së Rinasi. Lidhja me politikën, hije dyshimi mbi kompaninë që siguron aeroportin. PD: Fshihet avokati i Ramës

Ekstrakt historik i regjistrimit të shitjes së dhënës të subjektit "SHOQËRI ME PËRLEGJESË TË KUVIZIAR"

GJENDJA E REGJISTRIMIT	
1. Numri i artikullit të artikullit (NEN)	KR1112002
2. Data e regjistrimit	15/01/2009
3. Emri i subjektit	IKTI ALBANIA - INTEGRAITËT
4. Forma ligjore	SHOQËRI
5. Data e themelimit	25/01/2008
6. Kategoria	Nga 25/01/2009
7. Zona shtetërore dhe objektet e shpëtit	Territ. Limon (AKN) - Jon Penco, lokaliteti në Zonën Kallmetar 56, Nr. shtetërorë 1423, Niveli i Shkollës së Ulët - në fshat Limon, i qytetit Limon, Niveli i Shkollës së Ulët - në fshat Limon, Niveli i Shkollës së Ulët - në fshat Limon
8. Kapitulli	8.0000
9. Objektet e shpëtit	Pa i qenë asnjëra e objektit të shpëtit dhe pjesë, përfshirë edhe pjesë të objektit të shpëtit, siç janë: kompjuteri që të përdoret në ligjënetë dhe të shpëtitet dhe pjesë të objektit të shpëtit, shpëtitet të shpëtitet dhe pjesë të objektit të shpëtit, shpëtitet të shpëtitet dhe pjesë të objektit të shpëtit, shpëtitet të shpëtitet dhe pjesë të objektit të shpëtit, shpëtitet të shpëtitet dhe pjesë të objektit të shpëtit
10. Adresa e objektit	Edi Rama (AKN) - Jon Penco, lokaliteti në Zonën Kallmetar 56, Nr. shtetërorë 1423, Niveli i Shkollës së Ulët - në fshat Limon, i qytetit Limon, Niveli i Shkollës së Ulët - në fshat Limon
11. Kushtet e komercit	Edi Rama (AKN) - Jon Penco, lokaliteti në Zonën Kallmetar 56, Nr. shtetërorë 1423, Niveli i Shkollës së Ulët - në fshat Limon, i qytetit Limon, Niveli i Shkollës së Ulët - në fshat Limon
12.1. Vlera e kapësit	Pesha 1.000.000,00
12.2. Niveli i gabimit	1.500,00



(Në foto) Faksimile e ekstraktit historik. Momenti i grabitjes në Rinasi. Vila e Admir Murataj

Në faqet 6-7

ISH-DEPUTETI I PD

"Babalja", Ervin Salianji çohet në gjykatë për kallëzim të rremë

Në faqen 2

TAKIMI

Ministri Cakaj përplaset me Daçiç: Për shkakun tënd kam 28 vjet refugjat

Në faqen 4

SAMITI 16+1

Zbardhet takimi Rama-Tsipras, garanci për pronat e minoritetit

Në faqen 5

STUDIMI

Ndërtimet pa leje, 94 mijë objekte që nuk kualifikohen

Në faqen 8

"BLUETOOTH"

ISLI ISLAMI: Ndishim i përkëdhelur nga reagimet e publikut femëror

Suplement

Operacioni i policisë në 3 qytete, Klajdi Gjedit i gjendet gjysmë kg kokainë

Kapet me drogë, pranga mikut të Shullazit

Sandër Lleshaj në Elbasan: Do t'igodasim grupet kriminale. 6 të arrestuar

ELBASAN - Një operacion antidrogë u ndërmor dje nga Policia e Shtetit në Elbasan dhe në Tiranë, ndërsa u arrestuan 6 persona, mes të cilëve edhe një anëtar i grupit të Shullazit, Klajdi Gjedit dhe dy anëtarë të grupit të Çapjave. Ndërkohë që janë vënë nën hetim në gjendje të lirë dhe



tre persona të tjerë. Mësohet se gjatë këtij operacioni kanë përfunduar në pranga shtetasit: Klauçio Paik Trungu, Agron Ali Qafa, Skënder Ilir Pëllumbi, Lavdosha Iljaz Demaj, Lorencio Ardian Gjini si dhe Klajdi Ndue Gjedit. Ndërsa po hetohen në gjendje...

Në faqen 10

AKSIONI I OPOZITËS PROTESTA

Gjyqi, Basha paralajmëron gjyqtarin dhe prokurorët: Do ua bëjmë vetingun publikisht

"Babale" kalon për gjykim me 4 të pandehur, Salianji: Montim

Ish-deputeti, Veliu, Alizoti e Olldashi merren të pandehur

Valentina Madani

Gjykata e Tiranës kalon në gjykim dosjen "Babale" me të pandehur ish-deputetin Ervin Salianji, Fredi Alizoti, Albert Veliu dhe Jetmir Olldashi për akuzën e "Kallëzimit të rremë". Seanca paraprake në Gjykatën e Tiranës zgjati disa orë, teksa u vendos se Fredi Alizoti ka kërkuar gjykim të shkurtuar, ndërsa Salianji, Albert Veliu dhe Jetmir Olldashi kërkuan pushimin e gjykimit. Sipas vendimit të marrë nga togat e zeza, ish-deputeti Salianji do të merret i pandehur për akuzën e kallëzimit të rremë, së bashku me gazetarin Jetmir Olldashi, Albert Velin dhe Fredi Alizotin. Në audiopërgjimet e prokurorisë të publikuara prej tij nga selia e Partisë Demokratike, Salianji pretendon se Fredi Alizoti, që tashmë ka marrë përsipër se aktor zërin e Agron Xhafajit flet me ish-drejtorin e policisë së Fierit, Albert Nushi.

REAGIMI

Ish-deputeti i PD-së, Ervin Salianji ritheksoi se procesi ndaj tij për çështjen "Xhafaj" në Gjykatën Penale të Tiranës është i sajuar dhe i montuar. Duke folur teksa ka dalë nga gjykata, Salianji deklaroi se jo vetëm nuk do të ndalet në denoncime, por ka paralajmëruar se "do të kemi surpriza të tjera". Në dalje nga gjykata, ku ndoqi një pjesë të procesit, Salianji akuzoi prokurorët se ishin në krahun e trafikantit, i cili po vuan dënimin. Ish-deputeti demokrat i kërkon prokurorisë që të arrestojnë për dëshmi të rremë dy drejtuesit e policisë, Andon Markun dhe Alfred Nushin. "Prokurorët duhet të ishin në krahun tonë sot, duke denoncuar apo duke marrë të pandehur Agron Xhafajin për një veprë të re dhe jo të ishin ngjitur me avokatët e Agron Xhafajit. Ne jemi këtu për shkak se na ka denoncuar trafikanti i dënuar dhe duke kryer dënimin Agron Xhafaj. Aty ishin ngjitur me prokurorët edhe avokatët për t'i pasur si garanci", - tha ish-deputeti i PD-së. Z. Salianji i kërkon prokurorisë që të arrestojnë për dëshmi të rremë Andon Markun dhe Alfred Nushin. "U kërkova prokurorëve të marrin nën arrest për dëshmi të rreme Andon Markun dhe Alfred Nushin. Të dy kanë deklaruar se nuk e njohin Alfred Alizotin, por të dy janë në përgjime të kapur duke i dhënë para Alizotit", deklaroi z. Salianji. Sipas tij, "nuk ka veprë penale, prokuroria duhet të provojë fajësinë time, të mos kalojë fare në seancë, se nuk ka asnjë provë, vetëm indicie, telefonata apo thirrje hyrëse, që më ka bërë mua Albert Veliu, njohur si Babal-



Ish-deputeti Ervin Salianji

ERVIN SALIANJI

"Është një proces i montuar, qytetarët e kanë dëgjuar me provat e prokurorisë. I kërkova të marrin nën arrest Alfred Nushin dhe Andon Markon. Prokuroria nuk kishte as përgjigje për rastin. Sot duheshin marrë të pandehur që nga dy drejtuesit e parë të policisë, një deputet i PS-së dhe prokurorët e Krimeve të Rënda, që dalin dhe me përgjime. Do të kemi surpriza të tjera, në tre muaj përgjime, në çdo skut të prokuroria nuk ka gjetur një kontakt timin me Alizotin, por të deputetëve të PS", - tha z. Salianji.

Shehaj në Rumani: Ministrat e korruptuar arrestohen me protesta

Ish-deputeti demokrat Inga Bukureshti dje tregoi përvojën rumune në luftimin e korrupsionit. Shehaj shprehet se në shtetin rumun, ministrat dhe zyrtarët e lartë janë dërguar në burg nën akuzat e korrupsionit me anë të protestave popullore dhe se diçka e tillë duhet të ndodhë edhe në Shqipëri. "Të dashur miq, sot (dje) kam qenë pjesë e disa takimeve dhe diskutimeve me politikanësh europianë në Rumani, organizuar nga IRI. Mësimet vëra për Shqipërinë. Rumania dhe vendet e tjera që kanë luftuar me sukses korrupsionin, dëshmojnë një të vërtetë: po nuk u futën politikanët



e korruptuar në burg, nuk ka asnjë shpresë për qeverisje të mirë. Ka vetëm një mënyrë si luftohet korrupsioni: nxjerrjen para drejtësisë të politikanëve të korruptuar. Një kryeministër, ministër apo ish-ministër në burg, është kura e vetme kundër korrupsionit. Kjo mund të arrihet vetëm nëse të gjithë ngrihemi për të kërkuar fundin e pandëshkueshmërisë për korrupsionin dhe krimin. Është e

mundur që politikanët të fusin në burg kolegët e tyre të korruptuar? Po, nëse kanë presionin e opinionit publik. Vetëm populli mund ta arrijë këtë gjë. Ndaj ftoj të gjithë shqiptarët, miq, mbështetës, të afërm, qytetarë të Vlorës dhe të gjithë Shqipërisë të bashkohemi kundër korrupsionit, nesër (sot) në orën 18:00 në Tiranë", shkruan Shehaj në "Facebook".

ja". Salianji bëri të qartë se në katër muaj përgjime, organi i akuzës nuk ka mundur të gjejë një kontakt mes tij dhe Alizotit.

PARALAJMËRIMI

Për çështjen "Babale" reagoi edhe kryetari i opozitës, Lulzim Basha, duke e cilësuar skandal, ndërsa paralajmëroi gjyqtarët dhe prokurorët: "Kriminalët nuk hetohen, denoncuesit çohen në gjykatë, dua ta dënoj këtë akt kriminal,

dua t'ia bëj të qartë Kastriot Gramshit dhe prokurorëve të çështjes se nuk do ia hedhin kollaj me këtë akt që ka ndërmarrë. Nuk do ta kalojnë dot vetingun, vetingun publik, për këtë zotohem sot". Përgjigjen e merituar sipas Kodit Penal të Shqipërisë, i premtim kujtdo që bazuar në përgjimin që çoi pas hekurave në shtetin fqinj, Itali, Agron Xhafajin, vëllain e ministrit të Brendshëm të kohës, pushoi hetimin për

narko-trafik ndaj tij dhe ngri-ti akuzë për "kallëzim të rremë" ndaj denoncuesve. "Kur më parë në asnjë skandal shtetëror nuk është treguar më qartë se si funksionojnë të bashkërenduara me komandë politike organet e ngarkuara me ligj për të mbrojtur liritë dhe të drejtat e njeriut dhe për të çuar përpara përgjegjësisë penale, shkelësit e ligjit", tha z. Basha. Një skemë, që sipas Bashës është e qartë për këdo

Protesta, ambasada e SHBA-ve, thirrje qytetarëve: Evitoni Kryeministrinë e parlamentin!

Ambasada e SHBA-ve në Tiranë përmes një njoftimi të posaçëm u bëri thirrje qytetarëve amerikanë që të evitojnë zonën e Kryeministrisë, në orën 18:00, kohë kur do të mbahet edhe tubimi i opozitës. Në të njëjtën kohë, ambasada kërkoi nga shtetasit amerikanë që po ashtu të evitojnë edhe zonat përreth Kryeministrisë dhe parlamentit. Ndërsa theksoi se kohëzgjatja e protestës nuk dihet ende. "Evitoni zonën të Kryeministrisë në orën 18:00. Kohëzgjatja e protestës nuk dihet. Evitoni zonat përreth Kryeministrisë dhe parlamentit", thuhet në njoftimin e ambasadës. Kjo nuk është hera e parë që në protestat e opozitës, ambasada amerikane u kërkon shtetasve të saj të qëndrojnë larg vendeve të tubimeve. Kjo, për shkak të akteve të dhunës, që jo në pak raste kanë karakterizuar protestat e opozitës së bashkuar. Po ashtu, ambasada e SHBA-ve, por edhe shërbimet e tjera diplomatike në vendin tonë kanë dënuar aktet e dhunës të shfaqura në protestë, duke bërë thirrje për tubime paqësore.



që ka ndjekur përgjimet e bëra publike nga forca politike që drejton. "Ja pra shkelësit e ligjit, Agron Xhafaj, Alfred Alizoti, Balla, Nushi, Marko, prokurori Osmani, kupola e SHISH e përfshirë në këtë skandal, vetë drejtori i Përgjithshëm i Policisë Veliu, të gjithë së bashku të kapur në përgjime zyrtare të prokurorisë, duke fabrikuar një dëshmitar të rremë. Një ish-të dënuar për trafik droge,

Alfred Alizoti, i cili ka pranuar të dënohet me një vit burg dhe të pranohet se është ai dhe jo Geron Agron Xhafaj zëri i interceptuar nga gazetari Jetmir Olldashi. Prokuroria nuk ka guxuar as të thërrasë dhe të nisë hetimet për personat e interceptuar nga vetë prokuroria", u shpreh kreu i PD-së. "Jo vetëm kaq, por vetë kryeministri deklaroi Basha - promovon autorët kryesorë të këtij krimi".

Një nga protestat e fundit të opozitës

LULZIM BASHA

"Edi Rama ka marrë në mbrojtje dhe ka promovuar personat e përfshirë në këtë krim të rëndë shtetëror. Sot prokurorët e çështjes dhe një gjyqtar janë pengje të vetingut, pra çuan në gjykatë denoncuesit e krimin. Dua t'i bëj të qartë Kastriot Gramshit dhe dy prokurorëve se nuk do ia hedhin vetingut me këtë akt që kanë ndërmarrë", - deklaroi z. Basha.



Basha, Ramës: Zgjedhje pa opozitën nuk ka! Sondazhet na nxjerrin të parët

'S'do të ketë çadër', zbardhen detajet e protestës së opozitës

Masa shtesë para Kryeministrit, Kuvendit dhe Piramidës

Valentina Madani

Opozita do të protestojë sërish sot para Kryeministrit me kërkesën për largimin e Edi Ramës. Ndryshe nga herët e tjera qytetarët do të mbledhen para Kryeministrit në orën 18:00. Pas 2 muajsh protesta masive, por dhe protesta para Kuvendit, mbështetësit e opozitës do të përqipen sërish të tregojnë forcën se shumica tashmë janë ata. Skenari i protestës është i ngjashëm me atë të dy protestave të tjera masive, ky qytetarët do të mbledhen para Kryeministrit, dhe në dy pjesët anësore të saj ana e Piramidës dhe në rrugën "Ismael Qemali". Ndërkohë policia është në ngjashmëri. Rreth 1300 forca policie janë angazhuar për mbarrëvajtjen e protestës, ku pjesa me e madhe do vendosen para Kryeministrit, një pjesë tjetër në anën e piramidës, ndërsa do bllokohet çdo lëvizje në rrugën Ismail Qemali. Shtyllat janë lyer me graso për të pamundësuar që protestuesit të ngjiten dhe të dëmtojnë kamerat e sigurisë, ndërhyrje është bërë edhe në ndriçim. Instalacioni në hyrje të Kryeministrit vijon të jetë i izoluar; ndërsa rrjeta teli janë vendosur dhe përfaqësuesit të opozitës në kryeministrit, luajtësve ngjitur, por dhe piramidës. Në qendër të vëmendjes së policisë ka qenë edhe godina e Kuvendit, ku ndryshe nga protesta e fundit janë marrë masa shtesë për mbrojtjen e saj.



Kreu i PD-së, Lulzim Basha, dje në Fier

PROTESTA
Instalacioni në hyrje të Kryeministrit vijon të jetë i izoluar, ndërsa rrjeta teli janë vendosur dhe përfaqësuesit të opozitës në kryeministrit, luajtësve ngjitur, por dhe piramidës. Në qendër të vëmendjes së policisë ka qenë edhe godina e Kuvendit, ku ndryshe nga protesta e fundit, janë marrë masa shtesë për mbrojtjen e saj.

MESAZHI

"Edi Rama dhe banda e tij e dinë fare mirë se zgjedhje, palo zgjedhje, zgjedhje false pa opozitën nuk do të ketë. Kauza e çlirimit të Shqipërisë nga banda e Edi Ramës është përqafuar nga shumica dërrmuese e shqiptarëve", - deklaroi z. Basha.

Meta, apel para protestës: Të krijojmë një klimë dialogu në politikë

Një ditë para protestës së opozitës para Kryeministrit, Presidenti Ilir Meta u bën apel palëve që të ulen dhe të dialogojnë për të dalë nga kriza politike. Presidenti flet për nevojën e krijimit të një klime të re të dëgjimit të njëri-tjetrit, për të qenë të hapur ndaj mendimit kritik. Meta shkruan në "Facebook" se palët duhet të dëgjojnë njëri-tjetrin. "E kemi të domosdoshme të krijojmë një klimë të re të dëgjimit të njëri-tjetrit, jo vetëm në mjediset universitare e shoqërore, por edhe në ato politike, duke qenë gjithnjë të hapur ndaj mendimit kritik dhe përmirësues, në mënyrë që shoqëria jonë të reflektojë dhe të reformohet vazhdimisht", - tha Meta. Më herët presidenti Meta kërkoj që të respektohet autonomia e universiteteve. Sipas kreut të shtetit politika duhet të qëndrojë larg arsimit të lartë ndërsa bëri apel që të plotësohen sa më parë kërkesat e studentëve si dhe të merren masa për të ndaluar emigrimin e të rinjve. Duke kundërshtuar cenimin e autonomisë ia thekson se është më e rëndësishme forcimi i kërkimit shkencor në mënyrë që të sigurohet tregu i punës. "Protestat e drejta të studentëve gjatë dhjetorit të kaluar treguan se zbatim i ligjit aktual të arsimit të lartë ka probleme dhe vështirësi për të siguruar autonominë dhe pavarësinë financiare të duhur për një funksionim më të mirë dhe më cilësor e më të aksesueshëm të universiteteve publike. Njëkohësisht edhe për sa i takon përfshirjes së duhur edhe të studentëve në organet përfaqësuese dhe administrative. Reforma në arsimin e lartë dhe kërkimi shkencor duhet të ketë një frymë më gjithëpërfshirëse dhe duhet të synojë krijimin e kushteve të duhura për të përmirësuar cilësinë e mësimdhënies dhe njëkohësisht të përdorimit dhe menaxhimit të burimeve të brendshme njerëzore dhe financiare të universiteteve në mënyrë të paruar dhe të pakushtëzuar nga politika", - tha z. Meta.



sitateve. Sipas kreut të shtetit politika duhet të qëndrojë larg arsimit të lartë ndërsa bëri apel që të plotësohen sa më parë kërkesat e studentëve si dhe të merren masa për të ndaluar emigrimin e të rinjve. Duke kundërshtuar cenimin e autonomisë ia thekson se është më e rëndësishme forcimi i kërkimit shkencor në mënyrë që të sigurohet tregu i punës. "Protestat e

drejta të studentëve gjatë dhjetorit të kaluar treguan se zbatim i ligjit aktual të arsimit të lartë ka probleme dhe vështirësi për të siguruar autonominë dhe pavarësinë financiare të duhur për një funksionim më të mirë dhe më cilësor e më të aksesueshëm të universiteteve publike. Njëkohësisht edhe për sa i takon përfshirjes së duhur edhe të studentëve në organet përfaqësuese dhe administrative. Reforma në arsimin e lartë dhe kërkimi shkencor duhet të ketë një frymë më gjithëpërfshirëse dhe duhet të synojë krijimin e kushteve të duhura për të përmirësuar cilësinë e mësimdhënies dhe njëkohësisht të përdorimit dhe menaxhimit të burimeve të brendshme njerëzore dhe financiare të universiteteve në mënyrë të paruar dhe të pakushtëzuar nga politika", - tha z. Meta.



Ambasadorja gjermane, thirrje partive: Merrni pjesë në zgjedhjet lokale

Ambasadorja e Gjermanisë në Tiranë, Susanne Schütz u bën dje thirrje të gjitha partive të shfrytëzojnë rastin e të marrin pjesë në zgjedhjet lokale. Ambasadorja Susanne Schütz dhe Erida Skëndaj, Drejtoreshë Ekzekutive e Komitetit Shqiptar të Helsinkit (AHC), ranë dje dakord për të bashkëpunuar në procesin e vëzhgimit gjatë zgjedhjeve lokale të 30 qershorit. Qeveria Federale do ta mbështesë AHC-në me fonde të "Paktit të Stabilitetit për Europën Juglindore". Me rastin e nënshkrimit të kësaj kontrate subvencionore në ambasadën gjermane, ambasadorja Schütz deklaroi se, "zgjedhjet e lira, të barabarta dhe të fshëhta janë baza e çdo demokracie të shëndetshme. Është me rëndësi thelbësore që zgjedhësit/et të mund të kenë besim në një zhvillim të rregullt të procesit zgjedhor". "Ndaj gëzojmë që Gjermania, përmes këtij projekti të AHC-së, do të plotësojë përpjekjet e misioneve të tjera të vëzhgimit. Masat e parashikuara nga AHC sikundër janë trajnimi i vëzhguesve dhe vëzhgimi real në qendrat e votimit do të kontribuojnë në zhvillimin e procesit zgjedhor sipas standardeve kombëtare e ndërkombëtare. Në të njëjtën kohë u bëj thirrje të gjitha partive të shfrytëzojnë rastin e të marrin pjesë në zgjedhjet lokale", - tha ambasadorja Schütz.

rmuese e shqiptarëve", deklaroi z. Basha. Kryetari i PD-së nga Fieri i kujtoi kryeministrit Rama se zgjedhje pa opozitën nuk do të ketë. Gjatë një takimi me simpatizantë në kudër të protestës së 13 prillit, kryedemokrati Basha tha se qeveria ka humbur çdo legjitimitet. "Banda në pushtet e Edi Ramës që ka humbur çdo legjitimitet moral dhe politik, sot qëndron si kërcënim më i madh për sigurinë e njerëzve, si shaktari numër 1 i varfërisë, mjerimit, braktisjes së vendit. Edi Rama dhe banda e tij e dinë fare mirë se zgjedhje, zgjedhje false pa opozitën nuk do të ketë. Kauza e çlirimit të Shqipërisë nga banda e Edi Ramës është përqafuar nga shumica dërrmuese e shqiptarëve", - u shpreh z. Basha.

TAKIMET

Mesazhin fundit para protestës, Lulzim Basha e dha nga qyteti i Fierit. "Edi Rama dhe banda e tij e dinë fare mirë se zgjedhje, zgjedhje false pa opozitën nuk do të ketë. Kauza e çlirimit të Shqipërisë nga banda e Edi Ramës është përqafuar nga shumica dërrmuese e shqiptarëve", deklaroi z. Basha. Kryetari i PD-së nga Fieri i kujtoi kryeministrit Rama se zgjedhje pa opozitën nuk do të ketë. Gjatë një takimi me simpatizantë në kudër të protestës së 13 prillit, kryedemokrati Basha tha se qeveria ka humbur çdo legjitimitet. "Banda në pushtet e Edi Ramës që ka humbur çdo legjitimitet moral dhe politik, sot qëndron si kërcënim më i madh për sigurinë e njerëzve, si shaktari numër 1 i varfërisë, mjerimit, braktisjes së vendit. Edi Rama dhe banda e tij e dinë fare mirë se zgjedhje, zgjedhje false pa opozitën nuk do të ketë. Kauza e çlirimit të Shqipërisë nga banda e Edi Ramës është përqafuar nga shumica dërrmuese e shqiptarëve", - u shpreh z. Basha.

NJOFTIM SHITJE ME ANKAND

ZYRA PERMBARIMORE GJYQESORE PRIVATE 'ILIA ELEZI'

Pasuria nr. 1/165+1-8/1, LLOJI 'APARTAMENT', VOLUMI 6, FAQE 179, SIPËRFAQE 57 M2, ZONA KADASTRALE 8350, TIRANË, NË PRONËSI TË Z. PËLLUMB META DHE ZNJ. RITA META.
ÇMIMI 3.850.000 LEKË - Data e zhvillimit të ankandit do jetë 09.05.2019.
CEL. 0684026666 ; 0693262866

KOSOVË-SERBI DEBATI

Qeveria holandeze ka kundërshtuar propozimin e ligjëvendësve

Kriminaliteti shqiptar, deputetët holandezë kërkojnë rikthimin e vizave

Deputetët holandezë i kërkojnë qeverisë së tyre që t'i kërkojë Brukselit zyrtar që të rikthejë rrëgjimin e vizave për shqiptarët. Shkak për këtë kërkesë është bërë zgjerimi që ka marrë krimi me origjinë shqiptare në Europë dhe në mënyrë të veçantë në Holandë. Deputetët konsiderojnë se kjo është mënyra e vetme për të ndaluar bandat kriminale që hyjnë në vend dhe masa është mbështetur nga zyrtarët e policisë së Amsterdimit dhe të drejtësisë, raportoi transmetuesi holandez 'NOS'. Macionet e propozuara nga kristiandemokratja Maddelein fan Toorenburg dhe anëtar i partisë ultradjathtiste Zitte Fricma, raportohet se



përkrahen nga policia e Amsterdimit e zyrtarë të Ministrisë së Drejtësisë dhe pritet të hidhen për votim të martën e ardhshme. Gjatë parashtrimit të argumenteve pro nismës së saj, deputetja Toorenburg tha se prej vitit

2010 kur vendit ballkanik iu hoqën vizat, mafia shqiptare vetëm sa është zgjeruar në mbarë Europën Perëndimore. "Na duhet të përdorim mekanizmin e emergjencës për ta anuluar lëvizjen e lirë me Shqipërinë, për sa kohë vendi nuk e ndreq situatën e vet me kriminalitetin. Një detektiv në Rotterdam më ka thënë se kriminelët shqiptarë që hiqen këtu si turistë sa herë ndalohen nga policia janë nga grupet më të dhunshme që ekzistojnë dhe kjo më frikëson. Nuk mendoj se jemi i vetmi vend që kemi një problem të tillë", - tha Toorenburg. Ministri i Jashtëm holandez, Stef Blok, i ka qajti propozimet e kolegëve

të tij të pashpresa, pasi që rikthimi i vizave të zyrtarizohet, do të duhet mbështetja e të gjitha vendeve të tjera europiane. Më i prerë në mbrojtje të Shqipërisë u tregua ministri holandez për Drejtësinë dhe Sigurinë, Ferdinand Graperhaus, i cili hodhi i poshtë pretendimet e propozuesve. Ai deklaroi se personalisht nuk mendon se ka lidhje të ndërsjellë mes kriminelëve shqiptarë në Holandë dhe lëvizjes pa viza në vend, por shtoi se problemën e kriminalitetit e ka shtruar edhe në vizitat me palën shqiptare, ku ka marrë garanci për bashkëpunimin në luftën ndaj tij.



Kryeministri Edi Rama në takim me kryeministrin kinez, Li Keqiang

Ministri në detyrë i kujtoi homologut serb krimet e serbëve ndaj kosovarëve

Gent Cakaj përplaset me Daçiç: Për shkakun tënd kam 28 vjet refugjat

Ministri serb kërkojë largimin e Pacollit nga takimi

Ministeriali i minitrave të Jashtëm të vendeve të Procesit të Berlinit, mbajtur në Varshavë të Polonisë është shoqëruar me një përplasje të fortë mes përfaqësuesve serbë dhe atyre shqiptarë. Çdo gjë ka nisur teksa gjatë takimit, zyrtar ministri i Jashtëm serb, Ivica Daçiç, ka kërkuar përjashtimin nga ky takim të përfaqësuesit të Kosovës, Behxhet Pacolli. Në fjalën e mbajtur në këtë takim, Daçiç deklaroi se Serbia nuk e njeh si shtet, pasi është pjesë e saj, ndaj tha se ministri i Jashtëm i Kosovës, Behxhet Pacolli nuk duhet të ishte pjesë e Ministerialit të Varshavës.

DEBATI

Por, teksa ai është larguar nga foltoria, fjalën e ka marrë ministri i Jashtëm në detyrë i Shqipërisë, Gent Cakaj, duke replikuar me deklaratën e homologut serb. Ai i kujtoi Daçiçit vitet e luftës në Kosovë dhe vuajtjet e popullit kosovar, që për shkak të dhunës dhe tmerrit serb është detyruar të kalojë dhe jetojë në emigrim. "E di që po më dëgjon, prandaj po të flas. Fjalimi i Daçiç është një retorikë e



shekullit XX dhe totalisht pa vend dhe pa sens. Daçiç ka 28 vite në politikë e unë kam 28 vite jetë. Por për shkak të 28 viteve të tij në politikë, unë kam 28 vjet refugjat", - ka thënë Cakaj. Pas kësaj replike, Daçiç kërkoi të merrte fjalën sërish, por nuk u lejuua nga drejtuesi i Ministerialit. Dhe kjo duket se është bërë shkak që ai të largohet nga sala. Siç

shihet edhe në foton zyrtare, Daçiç mungon dhe nuk dihet nëse ka qenë një mungesë e rastësishme apo e qëllimshme e tij, për sa kohë që në radhën e ministrave të pozicionuar për tu fotografuar ishte edhe ministri kosovar, Behxhet Pacolli.

DEKLARATA

Nëdhëkohë që në fjalën e tij të mbajtur gjatë këtij takimi,

TAKIMI

Në takimin e organizuar nga Presidencia polake e Procesit të Berlinit, morën pjesë ndër të tjerë, edhe zyrtarë të Komisionit Evropian, të Shërbimit të Jashtëm të BE-së dhe të Zyrës Rajonale të Bashkëpunimit Rinor (RYCO).

ministri në detyrë për Evropën dhe Punët e Jashtme, Gent Cakaj, u shpreh se investimi për një Ballkan Perëndimor më të integruar e më të zhvilluar është në interesin e vetë Bashkimit Evropian. "Investimi i gjithanshëm politik, ekonomik, social dhe kulturor në Ballkanin Perëndimor; i kurorëzuar me integrimin në BE, është në interesin e përbashkët të të gjithëve, përfshi Evropën, për një kontinent të paqetë, të lirë dhe me një të ardhme më të begatë", - u shpreh Cakaj. Duke u ndalur në rolin e Shqipërisë në marrëdhëniet me fqinjët dhe rajonin, ministri Cakaj vuri në dukje se Sh-

SHKURT

Soreca: Fuqizoni institucionet e pavarura kyçe për integrimin në BE

Ambasadori i BE, Luigi Soreca, kërkoi dje fuqizimin e institucioneve të pavarura, pasi sipas tij, ato janë kyçe në procesin e integritetit të Shqipërisë në BE. Gjatë një takimi me institucionet e pavarura, të organizuar nga Kuvendi, Soreca tha se qeveria dhe parlamenti duhet të marrin masa për punën e rekomandimeve nga këto institucione. "Më lejoni së pari të them që unë jam këtu për të shprehur mbështetjen për punën e institucioneve të pavarura. BE inkurajon përpjekjet e parlamentit dhe qeverisë për të përmirësuar bashkërendimin dhe llogaridhënien në punën e institucioneve të pavarura. BE ka mirëpritur mekanizmin e monitorimit të parlamentit, kur ai u ngrit si i tillë. Po ashtu, kemi parë edhe hapat që janë ndërmarrë për fuqizimin e këtij mekanizmi. Është urgjente që ne të arrijmë rezultate më të prekshme dhe më të dukshme në publik. Këto përpjekje, të cilat prekin çdo element të arkitekturës shtetërore kërkojnë një angazhim të fort politik dhe teknik. Me funksionet tuaja rregullatore, institucionet e pavarura janë kyçe për qeverisjen demokratike. Për BE-në, roli në ruajtjen e balancave të pushteteve, por edhe të një sistemi të shëndetshëm ligjor si dhe një administratë publike e përgjegjshme janë tejet të rëndësishme. Institucionet e pavarura janë instrumentale për ecurinë e mëtejshme apo progresin për prioritetet kyçe për të cilat kanë rënë dakord BE-ja dhe Shqipëria", deklaroi z.Soreca.

qipëria ka në qendër të politikës së saj rajonale eliminimin e të gjitha problemeve me fqinjët dhe rritjen e bashkëpunimit kapilar në platforma dy, tre dhe shumëpalëshe. Cakaj përmendi takimet ndërqeveritare që Shqipëria ka mbajtur me Kosovën, Maqedoninë e Veriut dhe Malin e Zi, si dhe takime tre dhe katërpalëshe me vendet e rajonit si shembuj të një bashkëpunimi të qëndrueshëm dhe fryme rajonale të zhvillimit në Ballkanin Perëndimor. Duke e vlerësuar Procesin e Berlinit si një nisje komplekse më të integritetit evropian të Shqipërisë dhe rajonit në tërësi, ministri në detyrë,

Cakaj theksoi: "Procesi i Berlinit përpos aspektit teknik të bashkëpunimit nëpërmjet projekteve rajonale të infrastrukturës, emergjentikës, konaktivitetit etj., përmban edhe rëndësinë e dialogut politik", i cili sipas Cakajt, duhet të ngrihet në lartësinë e bashkëpunimit të sinqertë rajonal. "Nevojitet që ky Proces të rivalizohet dhe të ngrihet në nivelin e modelit që ofroi Marrëveshja e Prespës, arritur së fundmi mes Greqisë dhe Maqedonisë së Veriut. Vlerësoj se ky model do të ofronte sukses të konsiderueshëm edhe sa i takon dialogut të Kosovës me Serbinë", - tha Cakaj.



Dy kryeministrit u takuan në Samitin 16+1 mes Europës Juglindore dhe Kinës

Zbardhet takimi Rama-Tsipras, garanci për pronat e minoritetit

Rama i kërkoj kryeministrit kinez heqjen e vizave

Kryeministri Edi Rama mori pjesë në Samitin 16+1 mes vendeve të Europës Juglindore dhe Kinës, që u mbajt në Dubrovnik të Kroacisë. Krahas bisedimeve sipas formatit të këtij Samiti, kreu i qeverisë shqiptare zhvilloi edhe takime të veçanta me homologun e tij kinez, Li Keqiang dhe atë grek, Aleksis Tsipras. Sipas njoftimit zyrtar të Kryeministrit, në takimin me kryeministrin kinez biseda u përqendrua të forcimi i marrëdhënieve mes dy vendeve dhe në mënyrë të veçantë të hapja e tregut kinez për mallrat dhe produktet shqiptare.



Kryeministri Edi Rama në takim me homologun grek, Aleksis Tsipras

BISEDIMET
Tsipras bëri të qartë se kriteri kryesor për hapjen e negociatave të Shqipërisë për anëtarësim në Bashkimin Europian është respektimi i të drejtave të minoritetit grek. Rama dhe Tsipras diskutuan për të drejtën e pronës së minoritetit dhe në këtë kontekst, kryeministri Tsipras e konsideroi hap pozitiv, zgjidhjen e problemit të pronës së minoritetit grek në Himarë.

Ruçi, kritik me institucionet: Raportimet në Kuvend të jenë korrekte

Kryetari i Kuvendit, Gramoz Ruçi, zhvilloi dje një takim me drejtuesit e 21 institucioneve të pavarura, të cilat raportojnë në Kuvendin e Shqipërisë. Në fjalën e tij, ai u ndal në raportimet e bëra nga këto institucione në Kuvend, sipas të cilit, në të shumtën e rasteve nuk janë korrekte. "Institucionet e pavarura nuk mund të pengojnë rrezen e kontrollit parlamentar. Duhet të bëhen më diplomatike në punën e tyre, që bëhen pjesë e rezolutave. Në Kuvend nuk është përcjellë asnjë informacion. Në raportimin e fakteve ligjore janë për ta raportuar edhe 13 institucione. Disa prej jush kërkojnë edhe shlyerje afati. Në zbatim të nenit 103 të rregullores së Kuvendit, Kuvendi ka miratuar mjaft rezoluta për institucionet e pavarura", - tha kryetari i Kuvendit. Më tej, ai theksoi nevojën për reagimin e institucioneve ndaj rekomandimeve që jep Kuvendi. "Raportimet duhet të jenë sa më korrekte dhe në fund në dhënien llogari ndaj qytetarëve. Disa institucione nuk janë të qarta në raportim. Institucionet duhet të tregohen më të ndjeshme në rekomandime. Dua t'i tërheq vëmendjen Këshillit të Ministrave dhe Ministrisë për Marrëdhënien për Parlamentin që duhet të shqyrtojë më shumë. Shërbimi i Monitorit duhet të trajtojë më imtësi çështjet me ndjeshmëri", - tha Ruçi. Ndërkohë që kreu i Institutit të Studimeve të Krimeve dhe Pasojave të Komunizmit, Agron Tufa, i kërkoi kreut të Kuvendit të merren masa ndaj Spartak Brahos, pasi sipas tij, ai e ka kërcënuar dhe shantazhuar në një mbledhje të Komisionit të Ligjeve.



KINA
Gjatë këtij takimi, kryeministri Rama i kërkoj homologut të tij përshpejtimin e procedurave që do të lejonin hyrjen e disa produkteve ushqimore në tregun kinez. Nga ana tjetër, kryeministri Rama duke iu referuar 70-vjetorit të vendosjes së marrëdhënieve diplomatike mes dy vendeve, i kërkoj kryeministrit Li edhe heqjen e ndërsjellë të vizave mes dy vendeve, çka do të nxishte jo vetëm rritjen e numrit të turistëve kinezë në Shqipëri, por edhe rritjen e shkëmbimeve tregtare mes dy vendeve. Nga ana e tij, kryeministri Li Keqiang konfirmoi heqjen e çdo bariere për importin e verës, mjaltit dhe vajit të ullirit shqiptar. Gjithashtu, kreu i qeverisë kineze premtoi ndërmarrjen e hapave të nevojshme për heqjen e vizave, si dhe njohjen e ndërsjellë të diplomave universitare.

TSIPRAS
Më pas kryeministri Rama zhvilloi një takim me kryeministrin grek, Tsipras, me të cilin biseda u përqendrua në reformat e ndërmarrja nga Shqipëria me synim hapjen e negociatave me Bashkimin Europian si edhe në nxitjen e mëtejshme të marrëdhënieve dypalëshe jo vetëm në rrafshin politik e të fqinjësisë së mirë, por edhe në shkëmbimet tregtare dhe investimet e hua-

ja. Sipas njoftimit zyrtar, kryeministri Rama vlerëson qëndrimin e Athinës zyrtare mbi të ardhmen e Shqipërisë në BE dhe rolin që qeveria greke luan për çeljen e negociatave mes Shqipërisë dhe BE. Ndërkohë që media greke ka zbardhur një pjesë të diskutimeve mes dy kryeministrave, ku duket se çështja e pronave të minoritetit grek ka qenë në qendër të bisedimeve. Sipas agjencisë greke të lajmeve, e cila u referohet burimeve diplomatike, Tsipras bëri të qartë se kriteri kryesor për

hapjen e negociatave të Shqipërisë për anëtarësim në Bashkimin Europian është respektimi i të drejtave të minoritetit grek. Rama dhe Tsipras diskutuan për të drejtën e pronës së minoritetit dhe në këtë kontekst, kryeministri Tsipras e konsideroi hap pozitiv zgjidhjen e problemit të pronës së minoritetit grek në Himarë, çështje për të cilën disa ditë më parë pati edhe një telefonatë mes dy kryeministrave. Agjencia greke e lajmeve shprehet gjithashtu se në diskutimin me Aleksis

Tsipras, kryeministri Edi Rama u zotua se do të përmbushë standardet e Bashkimit Europian në lidhje me respektimin e së drejtës së pronës së minoritetit. Rama-Tsipras folën edhe për tekstet shkollore, për forcimin e bashkëpunimit ekonomik mes dy vendeve dhe investimet në infrastrukturë. Ndërkohë që gjatë ditës së djeshme, qeveria publikoi në Fletoren Zyrtare vendimin që përcaktonte detyrimin që mos të bëhet asnjë regjistrim prone shtetërore pa u regjistruar më parë pronat e minoritarëve.



REPUBLIKA E SHQIPERISE
BANKA E SHQIPERISE
DEPARTAMENTI I ADMINISTRIMIT
SEKTORI I PROKURIMIT

TENDER I HAPUR KOMBËTAR

Banka e Shqipërisë kërkon të realizojë objektin e prokurimit: **"Blerje letër fashetimi, shirit plastik, lidhëse sigurie e plasmas, për nevojat e Bankës së Shqipërisë"**

"Banka e Shqipërisë fton kandidatët e interesuar, të marrin pjesë në procedurën e prokurimit "Tender i hapur kombëtar", për realizimin e objektit të prokurimit si më sipër, me **fond limit 4,518,000 Lekë**".

Dokumentet e tenderit mund të tërhiqen pranë Sektorit të Prokurimeve të Departamentit të Administrimit, të Bankës së Shqipërisë, me adresë: Rruga e Dibrës, Kompleksi "Hallili", Kulla A, Tiranë, Tel. 042419411 (ext. 1844), çdo ditë nga çdo person i autorizuar, me paraqitjen e një kërkesë me shkrim. Tërheqja e dokumenteve mund të bëhet vetëm pasi të keni bërë paraprakisht pagesën e pakthyeshme prej 500 Lekë, pranë një banke tregtare në Illogarinë e Bankës së Shqipërisë sipas detajeve të mëposhtme:

Përfutuesi: Banka e Shqipërisë
BIC: STANALTR
IBAN: AL68 1011 1008 0000 0000 2222 222L; BIC

Përkshkrimi: Blerje dokumente tenderi për tenderin me objekt: **"Blerje letër fashetimi, shirit plastik, lidhëse sigurie e plasmas, për nevojat e Bankës së Shqipërisë"**

Oferta duhet të paraqitet në zyrën e Sektorit të Prokurimeve, pranë Departamentit të Administrimit, në Bankën e Shqipërisë, deri më **datë 09 Maj 2019, ora 14:00**, kohë në të cilën do të hapet edhe tenderi, ku ftohen të marrin pjesë kandidatët ose përfaqësuesit e autorizuar të tyre.

GRABITJA NE RINAS

SIGURIA

"ICTS Albania" dhe "ICT Albania Integrated Services" janë e njëjta kompani

Lidhje me politikën, hije dyshimi mbi kompanitë e sigurisë në aeroportin e Rinasit

2 kompanitë janë regjistruar nga Panagiotis Kampouroglou

TIRANË

Vjedhja e dytë e shu mave të kosiderueshme në aeroportin e Rinasit ka ngritur akuzat të forta për kompaninë menaxhuese të sigurisë brenda aeroportit. Dëshmtimi i protokollit të sigurisë ka shaktuar jo vetëm akuzat në nivelet politike, por edhe hije dyshimi të lidhjes së disa kompanive me segmente të caktuara të drejtuesve Politikë të Partisë Socialiste. Kompania "ICTS Albania", që siguron perimetrin e brendshëm të aeroportit të vetëm të vendit është krijuar në vitin 2005 me administrator shtetasin grek, Panagiotis Kampouroglou, menjëherë pas marrjes së koncesionit monopoli nga kompania gjermane për 25 vjet. Referuar dokumenteve të Qendrës Kombëtare të Biznesit, që nga themelimi i saj, kjo kompani ofron shërbime sigurimi aviacioni, sigurimit detar dhe shërbime të tjera. Ndërkohë në vitin 2009 krijohet një tjetër kompani me emër tjuajse të njëjtë "ICTS Albania", por me prapatshtë "Integrated Services". Por, në kompaninë e re shfaqet si administrator sërish edhe shtetasi grek, Panagiotis Kampouroglou, që themeloi kompaninë e parë në 2005-ën. Një tjetër element që lidh dy kompanitë sipas regjistrimit tregtar është edhe kompania e madhe, "ICTS Europe Holdings B.V.", e cila është aksionerja më e madhe tek numrat e telefonit të dyja

EKSTRAKT HISTORIK I REGJISTRIT TREGTAR PËR TË DHËNAT E SUBJEKTTI "SHOQËRI ME PËRÇJEGJËSI TË KUFIZUAR"	
GJENDJA E REGJISTRIMIT	
1. Numri unik i identifikimit të subjektit (NUSI)	K91513022Q
2. Data e Regjistrimit	13/03/2009
3. Emri i Subjektit	ICTS ALBANIA - INTEGRATED SERVICES
4. Forma ligjore	SHPK
5. Data e themelimit	25/02/2009
6. Kohëzgjatja	Nga 25/02/2009
7. Zyra qendrore e shoqëritë në Shqipëri	Emri i punës: "ICTS Albania" - Prapa Preze, Llogjiti në Zonën Kadastrale 166/1, Niveli i punës: B4/23, Në krah të Universitetit Europian, Zona Business Park, Ndërtesa Nr.7, Tiranë
8. Kapitali	1.000.000
9. Objekt i aktivitetit	Randë dhe sigurtimi finak i objekteve publike dhe private, personave, jetëve dhe të dëmshmit të ditëveve, siqsi kategoritë arbë të përcaktuara me ligjin përkatës. Te sigurtitë shërbime sigurtimi aviacioni, shërbime të sigurtimit detar, shërbime të sigurtimit të transportit, shërbime të pengulimit të ligitë dhe shërbime të tjera të integruara. Te integruarëse janë pjesë në ofroresitë mënyra, të drejtuesve mbikqerësve të punëve.
10. Administratorin	Eno Bushi
11. Afati i emërimit	Nga 04/03/2013
11.1. Kushtet e emërimit nëse ndryshon nga pasqyrimi i ligjit	11.1. Kushtet e kompetencave (nëse ka)
12. Onakion	Eno Bushi
12.1. Vlera e kapitalit	Para: 1.000.000,00
12.2. Numri i pjesëve	1.000,00

ISH-AVOKATI I PS-së
Kompania e krijuar në 2009, "ICT Albania Integrated Services" në vitin 2013 bën administrator dhe aksioner të saj Eno Bushin, ish-avokat i Partisë Socialiste, i cili e mban këtë post dhe aksionet deri në 2016, ku më pas ia shtet kompanisë së madhe "ICTS Europe Holdings".



AKUZAT E BERISHËS
Ish-kryeministri Berisha, referuar grabitjes së të paktën 10 milionë eurove në aeroportin e Rinasit, shkruan se autori i kësaj vjedhjeje është kryeministri aktual, Edi Rama, i ndihmuar nga ministri i Brendshëm, Sandër Lleshaj dhe ministria e Energjetikës dhe Infrastrukturës, Belinda Balluku. Këtë përfundim Berisha e ka sjellë nëpërmjet një analize në rrjetin social "Facebook", ndërsa shkruan se, "ishte kjo treshe famoze që shndërroi aeroportin e Rinasit në bazën e narkoflotës ajrore të Reformatos, që e kalonte atë jashtë kontrollit të sistemit TMS dhe skanimit që shtroheshin në lokale me Reformaton".

Paloka: Faktet që lidhin avokatin e Ramës me kompaninë që siguron Rinasin

TIRANË - Nënkryetari i Partisë Demokratike, Edi Paloka, nga selia blu publikoi fakte, shiç tha ai, që lidhin avokatin e kryeministrit Edi Rama, Eno Bushin me kompaninë që merr 2 milionë euro për sigurinë e aeroportit të Rinasit. "Kompania ICTS Albania" dhe kompania ku avokati i Ramës kish të 25% të aksioneve (ICT Albania Integrated Services) janë e njëjta kompani, kanë një pronar "ICTS Europë". Të dyja kompanitë janë regjistruar nga i njëjti person, Panagiotis Kampouroglou. Të dyja kompanitë kanë të njëjtin administrator, Aldi Molloholli; kanë të njëjtin drejtor teknik për sigurinë, kanë ndryshuar adresë në të njëjtën kohë, në vitin 2011. Më pas të dyja kompanitë kanë ndryshuar pronarë, duke kaluar nga holandezët tek finlandezët, tha Paloka. "Pavarësisht grabitjes - vijoi ai - qeveria hesht dhe nuk e përmend kompaninë në fjalë. Paloka shkoi



më tej kur tha se "kjo kompani bën biznes me qeverinë "Rama" dhe se "ka marrë tendera në dho cep të Shqipërisë". Paloka shprehet ndër të tjera se, "kompania ICTS Albania operon në Shqipëri që prej 2005-ës, por sigururia kombëtare u cenua 2 herë brenda aeroportit të Rinasit gjatë qeverisjes së Edi Ramës. Një herë në 2016-ën, kur Sandër Lleshaj drejton-

Nga ana e Shoqërisë "Shërbimi Përmbarimor AB" Shpk është shpallur ankandi faza e parë për pasuritë e mëposhtme:
1. "Tirani-Hidrosist" me sipërfaqe trualli 1328 m2 (një mijë e treqind e njëzet e tetë) dhe sipërfaqe ndërtese 508 m2 (pesëqind e tetë) me Nr.Pasurie 691/31 në Zonën Kadastrale 1167, Vllumi 8, Faqe 94 me adresë Komuna Borçullë, Tiranë.
Cmimi fillestar për shitjen në ankand të pasurisë është 881.600 (steqind e tetëdhjetë e një mijë gjashtëqind)Euro.
2. "Tirani-Hidrosist" me sipërfaqe trualli 3761 m2 (tre mijë e shtatëqind e gjashtëdhjetë e një) dhe sipërfaqe ndërtese 1818 m2 (një mijë e tetëqind e tetëdhjetë) me Nr.Pasurie 691/30 në Zonën Kadastrale 1167, Vllumi 8, Faqe 93 me adresë Komuna Borçullë, Tiranë.
Cmimi fillestar për shitjen në ankand të pasurisë është 1.280.000 (një milion e dyqind e tetëdhjetë mijë) Euro.
Ankandi do të zhvillohet në datë 23.04.2019 në orën 16:00 pranë zyrës së shoqërisë "Shërbimi Përmbarimor AB" Shpk me Përmbarues Gjyqësor Privat Admir Boqiri që ndodhur në adresën Rr.Bul Zhan Dark Pall.Kulla.1.Teknoprojekt Shk.1 Kat.4 Ap.10 Tiranë.

SHPLLJE ANKANDI

Zyra Përmbarimor "E.G Bailiff Service" me përmbarues gjyqësor Enuar Merko me adresë Rr. Ibrahim Rruova, Pall 64, Hyrja 8, Ap 1, Tiranë, njofton se më datë 26.04.2019 ora 8⁰⁰ - 16⁰⁰ në ambientet e saj, do të zhvillohet: Ankandi i l-rë për shitjen e pasurive të paluajtshme në pronësi të Z. Shpëtim Barjam Bocit:
- Truall me sipërfaqe 2863 m², Nr.pasurie 88/16, Zona Kadastrale nr.2007, Vllumi 9, Faqe 107 ndodhur në Jorgucat Gjikostër, me vlerë fillestare në ankand 68.712 (Gjashtëdhjetë e tetë mijë e shtatëqind e dymbëdhjetë) EURO
- Truall me sipërfaqe 2317 m², Nr.pasurie 88/25, Zona Kadastrale nr.2007, Vllumi 9, Faqe 121 ndodhur në Jorgucat Gjikostër, me vlerë fillestare në ankand 55.808 (Pesëdhjetë e pesëmijë e gjashtëqind e tetë) EURO
- Truall me sipërfaqe 790 m², Nr.pasurie 88/23, Zona Kadastrale nr.2007, Vllumi 9, Faqe 119 ndodhur në Jorgucat Gjikostër, me vlerë fillestare në ankand 18.960 (Tetëmbëdhjetë mijë e nëntëqind e gjashtëdhjetë) EURO
- Truall me sipërfaqe 780 m², Nr.pasurie 88/20, Zona Kadastrale nr.2007, Vllumi 9, Faqe 111 ndodhur në Jorgucat Gjikostër, me vlerë fillestare në ankand 18.720 (Tetëmbëdhjetë mijë e shtatëqind e njëzet) EURO
- Truall me sipërfaqe 1750 m², Nr.pasurie 88/18, Zona Kadastrale nr.2007, Vllumi 9, Faqe 109 ndodhur në Jorgucat Gjikostër, me vlerë fillestare në ankand 42.000 (Dyzet e dy mijë) EURO
Të interesuarit të kontaktojnë në nr. e telefonit 0672027580, +355 4 22 31 888. email enuar.merko@gmail.com

Me vendim gjykate konfiskohen edhe 300 mijë euro si provë materiale

Zbulohen dhe sekuestrohen me vendim gjykate pasuritë miliona euro të familjes Murataj

Prokuroria: Nën sekuestro janë apartamente, vila, troje, pemëtore dhe 9 automjete


TIRANË

Admir Murataj, i cili mbeti i vrarë pak ditë më parë gjatë grabitjes së 10 mln eurove në aeroportin e Rinasit, rezultoi të ketë së bashku me familjarët e tij miliona euro pasuri, të cilat janë sekuestruar me kërkesë të Prokurorisë së Krimeve të Rënda. Apartamente, troje, pemëtore, vila dhe makina pafund janë pasuritë e sekuestruar familjes së 47-vjeçarit që konsiderohet si koka e grupit të grabitjes së Rinasit. E ndërsa, Admiri planifikonte të kryente grabitjen e radhës në pistën e Rinasit, organi i akuzës kërkonte sekuestrimin e pasurive të tij dhe familjarëve të afërt. Kjo, bazuar në hetimet për tre grabitjet e kryera më herët prej bandës së tij, dy në rrugën e Qafë Kasharit dhe një pranë Stacionit të Trenit. Mësohet se kërkesa është dorëzuar më 21 mars të këtij viti dhe më 25 mars gjykata e ka pranuar. Ndërkaq, burime zyrtare nga prokuroria bënë me dije se gjatë hetimit penal janë kryer verifikime për subjektet Admir Murataj dhe Aleksandër (Shpëtim) Murataj si dhe për 14 familjarë të tyre.

Prokuroria ka vendosur konfiskimin e 300 mijë eurove si prova materiale.

PASURITË E SEKUESTRUARA

Përveç sa më sipër, shtetasve Admir Murataj, Can Murataj, Aleksandër Murataj u janë sekuestruar në kuadër të procedimit penal pasuritë e mëposhtme: BMW X6 sekuestruar shtetasit Can Murataj; Fouristradë Mercedes Benz; Fuoristradë BMW X3 sekuestruar të pandehurit Aleksandër Murataj; DODGE, sekuestruar shtetasit Can Murataj; Volkswagen Tiguan; Land Rover Defender sekuestruar Cen Murataj; motoçikletë BMW sekuestruar në banesën e Admir Murataj; Rezultoi se Admir Murataj, Aleksandër Murataj, dhe familjarët e tij janë subjekte të hetimit pasuror pasi janë identifikuar pasuri që nuk justifikohen nga bu-



Admir Murataj



Familjarët e Admir Murataj

PASURITË E SEKUESTRUARA TË ADMIR MURATAJ E FAMILJARËVE TË TIJ

■ TRUALL DHE APARTAMENTE

1. Garazh 23 m², blerë 4.000 USD;
2. Apartament 100.5 m², blerë 41.740 dollarë;
3. Truall në emër Shpëtim Murataj (Aleksandër Murataj), 473.50 m² fituar me kontratë 2.998.500 lekë në Yzberisht, Tiranë;
4. Apartament 71 m² në emër të Albana Alidhima, në Sarandë, blerë 3.698.316 lekë;
5. Pemtore 608 m² në Mjull, Bathore, Tiranë, Albana Alidhima, blerë 1.200.000.
6. Apartament banimi në Sarandë, zona turizëm, Kanali i Çukës, porositur për 90.000 EURO;
7. Vila dy katëshe e pabanuar në Prezë, Vorë në pronësi të shtetasit Admir Murataj (Nikaj), por herë pas here shkon ta pastrojë bashkëshortja e Admir Murataj.

■ AUTOMJETE

1. BMW X6 sekuestruar shtetasit Can Murataj;
2. Fouristradë Mercedes Benz;
3. Fuoristradë BMë X3 sekuestruar të pandehurit Aleksandër Murataj;
4. DODGE, sekuestruar shtetasit Can Murataj;
5. DODGE (tjetër) sekuestruar shtetasit Can Murataj;
6. Mitsubishi sekuestruar shtetasit Can Murataj;
7. Volkswagen Tiguan;
8. Land Rover Defender sekuestruar Can Murataj;
9. Motoçikletë BMë sekuestruar në banesën e Admir Murataj.

rimet të ligjshme.

Konform ligjit nr.10192, datë 03.12.2009, ndryshuar me ligjin 70/2017 "Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe trafikimit, korrupsionit dhe krimeve të tjera nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë", plotësojnë kriteret e zbatimit të nenit 3 pika 1, "a", pasi shtetasit Aleksandër Murataj, dhe Admir Nikaj (Murataj), janë dërguar për gjykim nga për kryerjen e

veprave penale të "Vjedhja e bankave" më shumë se njëherë, në formën e grupit të strukturuar, "Krijimit dhe pjesëmarrjes në grup të strukturuar kriminal", të parashikuar nga nenet 136/2, 28/4, 333/a/1, 2 dhe 334/1 të Kodit Penal dhe ndaj tyre dhe familjarëve të tyre janë identifikuar pasuri, të cilat zotërohen plotësisht ose pjesërisht, në mënyrë të drejtëpërdrejtë ose të tërthortë, është e nevojshme aplikimi i

masave parandaluese ndaj pasurisë.

Në interpretim dhe zbatim të nenit 11 të ligjit nr. 10192 datë 03.12.2009 "Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit dhe korrupsionit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë", indryshuar me ligjin nr. 24/2014 konstatohet se plotësohen njëkohësisht dy kriteret e përgjithshme që kanë të bëjnë me: 1. Ekzistencën e dyshimit të arsyeshëm, të bazuar në indicje që tregojnë se personat mund të jenë përfshirë në veprimtari kriminale; 2. Zotërimi i pasurive apo të ardhurave, fitimeve apo veprimtarive të ligjshme, të deklaruara dhe as nuk justifikohen prej tyre; si dhe të paktën njërit prej kriterëve të veçanta, të parashikuara në pikat "a" dhe "b" të këtij neni. Në rastin konkret plotësohet pika a e këtij neni, pra ekziston një treqiz real për humbje, marrje apo tjetërsim të fondeve, pasurive apo të drejtave të tjera, mbi të cilat parashikohet vënja në zbatim e masës së konfiskimit, sipas dispozitave të këtij ligji, pasi nëse subjekti i dyshuar "pronar" Aleksandër (Shpëtim) Murataj, Admir Murataj (Nikaj), apo personi i lidhur Can Murataj mund të kryejnë veprime juridike për tjetërsimin e pasurisë së identifikuar në emër të tyre.

Për shtetasin Aleksandër Murataj ka pasuri të regjistruar në ZVRPP Tiranë:

Garazh 23 m², blerë 4.000 USD; Apartament 100.5 m², blerë 41.740 dollarë; Truall në emër Shpëtim Murataj (Aleksandër Murataj), 473.50 m² fituar me kontratë 2.998.500 lekë në Yzberisht, Tiranë;

Apartament 71 m² në emër të Albana Alidhima, në Sarandë, blerë 3.698.316 lekë; Pemtore 608 m² në Mjull, Bathore, Tiranë, Albana Alidhima, blerë 1.200.000; Apartament banimi në Sarandë, zona turizëm, Kanali i Çukës, porositur për 90.000 euro; Vila dy katëshe e pabanuar në Prezë, Vorë në pronësi të shtetasit Admir Murataj (Nikaj), por herë pas here shkon ta pastrojë bashkëshortja e Admir Murataj; Motoçikletë BMW X6 sekuestruar shtetasit Can Murataj; Fuoristradë Mercedes Benz; Fuoristradë BMW X3 sekuestruar të pandehurit Aleksandër Murataj; DODGE sekuestruar shtetasit Cen Murataj; DODGE (tjetër) sekuestruar shtetasit Cen Murataj; Mitsubishi sekuestruar shtetasit Can Murataj; Volkswagen Tiguan; Automjeti Land Rover Defender sekuestruar Cen Murataj; Motoçikletë BMW sekuestruar në banesën e Admir Murataj.

Ndaj pasuritë e identifikuar të shtetasve Admir Murataj, Aleksandër Murataj dhe familjarëve të tyre duhet t'i nënshtrohen sekuestros, bazuar në nenet 3 deri në 7, 11, 12, 14 dhe 15 e vijues të ligjit nr. 10192 datë 03.12.2009 "Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe trafikimit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë".



Tension te 313, vëllai i Admir Murataj nuk u lejuar të shkonte në varrim

TIRANË - Tension në burgun 313 në kryeqytet. Aleksandër Murataj, nuk i është dhënë leje nga Drejtoria e Përgjithshme e Burjeve të marrë pjesë ditën e djeshme në varrimin e vëllait, Admir Murataj, i cili mbeti i vrarë gjatë përplasjes me armë me policinë pas grabitjes në Rinas. Kjo gjë ka ngjallur zemërim jo vetëm tek ai, por edhe tek shokët e tij në burg, të cilët janë rebeluar duke shkakuar një situatë të pazakontë. Murataj kishte kërkuar leje prej autoriteteve dy ditë më parë për të marrë pjesë në ceremoninë mortore që zhvillohet sot në Tropojë, në vendlindjen e tyre. Aleksandër Murataj ndodhet në burgun 313 ku vuan dënimin me 16 vite për grabitjen e 2 milionë eurove nga blinda në Rinas, ndërsa për të gjithë grupin në total Gjykata dha 127 vite burg. Ndërkaq, një person misterioz që është "punësuar" për të shpërqendruar policinë po kërkohet nga blutë pas grabitjes së 10 milionë eurove në aeroportin e Rinasit, përveç 5 personave që kanë marrë pjesë në grabitje. Policia ka dyshime se grupi që ka punuar për realizimin e supergrabitjes është akoma më i madh. Mësohet se makina e djegur në Bathore u përdor si karrem për të shpërqendruar policinë.



Baret e restorantet në "shënjestër"

Më 17 prill nis fushata e re antinformalitet

Më 17 prill 2019 do të nisë fushata e antinformalitetit e përqendruar në sektorin e shërbimeve, kryesisht bare dhe restorante, duke i paraprirë kështu dhe afrimit të sezonit veror. Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve, Enton Duro, zhvilloi një takim informal me gazetarët e ekonomisë, ku shpallosi vizionin e tij në krye të këtij institucioni, i cili do të fillojë me fushatën antinformalitet, që është konceptuar e qëndrueshme në kohë dhe më shumë në formë ndërveprimi me bizneset, duke shmangur agresivitetin e aksioneve të kaluara. Përmes zbatimit të këtij plani, synohet rritja e përm-bushjes vullnetare e tatimpaguesve, si dhe ndërgjegjësimi i publikut mbi rëndësinë e mbledhjes së detyrimeve tatimore sipas legjislacionit në fuqi. Një tjetër objektivi është respektimi i afateve për rimbursimin e TVSH-së për subjektet, ku do të ndërtohet një axhendë transparente dhe e konsoliduar për

adresuar problematikat në këtë drejtim, duke u fokusuar tek subjektet që janë prekur më së shumti nga luhatjet e kursit të këmbimit. Objektivi është që të shlyhen 1.7 miliardë lekë në muaj dhe të mos cenohet plani i rimbursimit. Rreth 851 milionë lekë janë detyrimet që administratat tatimore ka për ti paguar eksportuesve për rimbursimin e TVSH-së, ndërsa fondi total për vitin 2019 është rreth 19 miliardë lekë.

Zbardhet studimi i Agjencisë së Legalizimit dhe Urbanizimit të Integritit të Zonave Informale

Ndërtimet pa leje, 94 mijë objekte që skualifikohen

Shtëpitë dhe bizneset që rrezikohen në 12 qarqe

Rreth 94 mijë objekte në të gjithë vendin janë skualifikuar nga procesi i legalizimit. Bëhet fjalë për shtëpi apo njësi tregtare në 12 qarqe të vendit, të cilat nuk mund të vijojë procedurat me legjislacionin aktual pasi nuk plotësojnë kriteret për t'u legalizuar. Të dhënat janë bërë të ditura në një studim që ka kryer ALUZIONI, sipas të cilit mësohet se në Tiranë nuk do të legalizohen rreth 47 mijë objekte.

RAPORTI

Agjencia e Legalizimit dhe Urbanizimit të Integritit të Zonave Informale në përfundim të një studimi të kryer gjatë vitit të kaluar njoftoi se mbi 94 mijë objekte pa leje të ndërtuara në të gjithë vendin nuk do të mund të përfitojnë nga procesi i legalizimit. Sipas Agjencisë së Legalizimit dhe Urbanizimit të Integritit të Zonave Informale ky kontingjent objektiv nuk mund të vijojë procedurat me legjislacionin aktual pasi nuk plotësojnë kriteret për t'u legalizuar.

NDARJA SIPAS QYTETEVE

Në studimin e ALUZIONI-t mësohet se pjesa më e madhe e objekteve që nuk përfitojnë nga legalizimi, ose rreth 50 për qind e tyre ndodhen në qarkun e Tiranës. Në këtë qark ka gjithsej 97,916 aplikime për legalizim, por 47,229 objekte janë përjashtuar tashmë nga procesi dhe vetëm 50 mijë do të legalizohen. Më tej në qarkun e Vlorës gjendet numri më i madh i banesave pa leje që nuk do të legalizohen me 9,800 e 9,700 secila. Në qarkun Për kanë aplikuar për legalizim rreth 39 mijë pronarë objektiv të ndërtuara pa leje dhe rreth 9800 prej tyre janë skualifikuar nga procesi. Qarku me numrin më të vogël të ndërtimeve pa leje është Kukësi, ku janë në total rreth 2700 ndërtime dhe janë skualifikuar nga procesi 352 objekte.

LIGJI

Sipas legjislacionit në fuqi neni 39 i ligjit për legal-

izimet përcakton se, ndërtime pa leje, shtetas anësore dhe/ose në lartësi në ndërtime me leje që, në bazë të akteve ligjore e nënligjore në fuqi, cenojnë veprat kryesore të infrastrukturës publike, akset rrugore kombëtare, territorin e institucioneve publike, integritetin e monumenteve të kulturës nuk legalizohen. Kriteret, procedurat dhe dokumentacioni i zbatueshëm për të kualifikuar ndërtime pa leje, shtetas anësore dhe/ose në lartësi, në ndërtime me leje, përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave. Në rastet kur, si pasojë e shqyrtimit të një mosmarrëveshjeje në gjykim ndërmjet subjektit dhe pronarit të truallit privat/kuftar, gjykata ka vendosur masë sigurimi, procedurat për legalizimin e shtesës së objektit pezullohen dhe rifillojnë sipas këtij ligji. Numri i prishëm i objekteve, që do të pajisen me leje legalizimi (diferenca midis "objekte të legalizueshme" dhe "leje legalizimi") deri në përfundim të procesit është 62.206.

QARKU:	APLIKIME:	OBJEKTE QE NUK LEGALIZOHEN	OBJEKTE TE LEGALIZUESHEM
BERAT	11,490	1,693	9.797
DIBËR	2,967	108	2.859
DURRËS	51,189	9,795	41.394
ELBASAN	32,925	226	32.699
FIER	39,731	9,805	29.926
GJIROKASTËR	3,710	352	3.358
KORÇË	12,709	7,216	4.493
KUKËS	2,692	747	1.945
LEZHË	16,565	4,042	12.523
SHKODËR	24,596	1,993	22.603
VLOBË	26,594	10,925	15.669
TIRANË	97,916	47,229	50.687
GJITHSEJ:	323.082	94.131	228.951

Nga Tiranë-Elbasan, te 'Bypas'-i i Fierit

Qato: Ja datat kur do të hapen akset rrugore për qarkullim

Drejtoresha e Autoritetit Rrugor Shqiptar, Sonila Qato ka konfirmuar edhe një herë se aksi rrugor Tiranë-Elbasan pritet të jetë tërësisht funksional për qarkullimin mjeteve më 17 maj të këtij viti. Këtë e ka bërë të ditur për 'ERTV Intervista', ndërsa ka folur mbi investimet në infrastrukturë si dhe mbi proceset e mirëmbajtjes së rrjetit rrugor. Sipas Qatos, janë një sërë aksesh të tjera rrugore të rëndësishme dhe sisteme të rrugëve që pritet të përfundojnë brenda vitit 2019. "Brenda vitit 2019 kemi për të përfunduar disa projekte të rëndësishme tashmë të nisura nga ana e Autoritetit Rrugor Shqiptar, natyrisht

me mbështetje të buxhetit të shtetit të qeverisë shqiptare. Siç flitet për mbylljen në datë 17 maj të aksit kryesor, një kas shumë problematik, një projekt i tejzgatur për shkak të mënyrës se si ishte hartuar dhe projektuar kontrata e rrugës Tiranë-Elbasan të cilën ne patëm rastin më datë 14 mars të hapnim korsinë e parë të lidhjes së kësaj rruge nga TEG-u deri kufi të rrethrotullimit në hyrje të Elbasanit, ku ambicia është që më datë 17 maj të dorëzojmë të plotë këtë rrugë", u shpreh Qato. Ndërkohë, ka shtuar më tej se më 29 prill do të hapet për mjetet dhe qytetarët, gjithashtu, edhe tuneli panoramik i rrugës Elbasan-Tiranë. "Përfundojmë rehabili-

timin e rrëshqitjes pas tunelit të kësaj rruge, të rrugës së Elbasanit e cila është korigjuar përmes një tuneli panoramik, i cili më 29 prill tashmë presim që ta hapim dhe të jetë i lirë për mjetet dhe qytetarët." Po ashtu, deri në fund të vitit do të përfundojë infrastruktura e veprave të arrit të 4 viadukteve në aksin Kukës-Morinë, e cila përfshin pajisjen me të gjitha elementët e sigurisë rrugore. Brenda vitit do të mbyllet punimet edhe për aksin Elbasan-Banjë si dhe ato për lotin e parë Skrapar-Përmet duke lehtësuar kështu trafikun. "Do të përfundojmë infrastrukturën e veprave të arrit 4 viadukte në rrugën kryesore kombëtare Kukës-Morinë, e cila do të



pajiset deri në fund të këtij viti me të gjithë elementët e rruajtjes së sigurisë rrugore të këtij aksi kaq të rëndësishëm. Përfundojnë punimet në aksin Elbasan-Banjë, janë dy lote, të cilat janë duke punuar ato. Lotin e parë të Skrapar-Përmet dhe disa asfaltime dhe sisteme të tjera në kuadër të mirëmbajtjes, të cilët do ta lehtësojnë trafikun dhe transportin për shkak të rritjes së standardit të këty-

re rrugëve", deklaroi Qato. Ndërkaq, ndërsa është ndalur në punimet që po kryhen në bypasin e Fierit, Qato ka deklaruar se njëra korsia do të jetë funksionale më 30 qershor. "Kontraktori është duke punuar me ritme shumë të larta për të mbajtur premtimin, në mënyrë që me datë 30 qershor një korsia e bypasit të Fierit të jetë e hapur për qarkullimin e të gjitha automjeteve, me përjashtim të mjeteve të rënda. Janë duke punuar me dy turne, janë duke punuar në disa pika të këtij kantieri për të mbaruar në kohë reale veprat e artit që kërkohen nënën e tyre dhe kanë dhe një kosto të konsiderueshme, por premtimi për shkak të ritmit të punës, të cilën ne e monitorojmë përditë do të mbahet me qëllim që brenda datës 30 qershor ky aks dhe korsi të jetë e hapur për lëvizjen brenda sezonit turistik që të mund të shfrytëzohet nga të gjithë turistët dhe qytetarët e vendit", tha Qato.

Shqipëria, me kosto 10 herë më të ulët të punës në krahasim me mesataren e BE-së


Kostoja mesatare në Shqipëri, 2.5 euro për orë pune

INSTAT: Në Europë koston mesatare të punës ishin 27.4 euro

Një kompanie që operon në Shqipëri, një orë pune i kushton mesatarisht 2.5 euro. Mesatarja e koston së punës në vendet e Bashkimit Europian është 27.4 euro në orë. Shqipëria ka koston më të lirë për orë pune, ndërsa më të lartën e ka Norvegjia, ku kostoja e një ore pune është 50 euro. Referuar të dhënave INSTAT, krahasuar me mesataren e Bashkimit Europian, kostoja e punës në Shqipëri kushton 10 herë më pak, sipas Eurostat. Kosto e lirë e fuqisë punëtore vijon të jetë avantazhi kryesor konkurrues i Shqipërisë, që ka tërhequr që pas viteve '90 industrinë fasonë (që punojnë me material porositi), kryesisht në tekstilë e këpucë dhe së fundmi edhe në industrinë mbështetëse të prodhimit të pjesëve elektrike të automjeteve.

RENDITJA

Pas Shqipërisë, në BE vendet me koston më të lirë për një orë punë janë Bullgaria, ku në 2018-ën, sipas Eurostat një orë pune kushtonte 5.4 euro, ndërsa në Rumani rreth 6.9 euro. Në të gjithë ekonominë e Bashkimit Europian duke përfshirë administratën publike, koston mesatare të punës ishin 27.4 euro, me një rritje prej 2.7 për qind në krahasim me një vit më parë. Në vendet ku përdoret monedha euro, koston mesatare për orë pune ishin më të lartë. Në 2018-ën, ato u përllogariten rreth 30.6 euro. Për 2018-ën, vendet me koston më të lartë të punës ishin Norvegjia me 50 euro për orë, Danimarka me 43.5, Islanda me 42.5, Luksemburgu me 40.6. Kosto mesatare për orë të punës në Francë në 2018-ën u përllogarit 35.8 euro, mbi mesataren e Bashkimit Europian, por jo ndër vendet me koston më të lartë. Megjithatë, në Francë koston që nuk lidhen me pagën e punonjësit zënë peshën më të lartë në struk-



turën e kostove të punës në atë vend. Sipas tabelës së Eurostat, koston që nuk kanë lidhje me pagën zënë rreth 32.6% të totalit të strukturës së kostove të punës. Me pas renditen Suedia, Lituania dhe Italia, ku koston e tjera përjashtuar pagën zënë përkatësisht 32.3%, 29.2% dhe 28.4%. Koston e punës në orë janë rritur më shumë në Rumani, më pak në Maltë. Në vitin 2018, krahasuar me vitin paraprak, koston e punës për orë në të gjithë ekonominë u rritën me 2.7% në BE dhe me 2.2% në eurozonë. Në zonën Euro, rritjet më të mëdha u regjistruan në Letoni (+ 12.9%), Lituani (+ 10.4%), Estonia dhe Sllovakia (të dyja + 6.8%). Koston e punës në orë janë rritur më pak në Maltë (+ 0.4%), në Finlandë (+ 1.2%), Spanjë (+ 1.3%) dhe Portugali (+ 1.4%).

Ndëshkohen 41 biznese, "kapen" 297 punonjës informale

Në 3 muajt e parë të vitit 2019 janë kontrolluar 3533 subjekte për zbatim të legjislacionit të punës, një shifër 2.2 herë më lartë se e njëjta periudhë e një vitit më parë. Sipas raportit zyrtar të Inspektoratit Shtetëror të Punës, rezultoni se janë ndëshkuar me gjoja 41 subjekte për shkak se kanë shkelur legjislacionin, me një vlerë totale prej 10 milionë lekësh. Po ashtu, ajo që vihet re nga të dhënat është infomaliteti, i cili vijon të mbetet një fenomen i vazhdueshëm në bizneset shqiptare. Vetëm në 3 muajt janë evidentuar 297 punëmarrës në të zezë. Në raport mësohet se në total janë inspektuar 73517 vende pune në subjekte private dhe shtetërore. Referuar llojit të aktivitetit, fokusi më i madh ka qenë në sektorin tregti-hotel-bare dhe restorante që përbën edhe 44 për qind të numrit total të inspektimeve. Po ashtu, edhe ndërmarrjet prodhuese kanë qenë në vëmendje me 24 për qind të totalit të inspektimeve, aktivitetet të tjera me 17 për qind si dhe më pak kontrolle janë zhvilluar në transport, magazinim, telekomunikacion si dhe financë dhe shërbime të sigurimeve.

ERRU miraton tarifat e reja në 3 qytete, 10 të tjera në proces

Banorët dhe bizneset e Gjirokastrës, Poliçanit dhe Delvinës do të paguajnë më shtrenjtë ujën e pijshëm. Enti Rregullator i Ujit ka miratuar rritjen e tarifave për këto qytete, duke pranuar kërkesën e shoqërive të ujësjellës-kanalizimeve. Më konkretisht në Gjirokastrë tarifa e ujit për abonentët familjarë bëhet 46 lekë/m3 nga 43 lekë/m3 që ishte aktualisht, ndërsa për bizneset rritet me 8 lekë, duke shkuar në 138 lekë/m3. Në Poliçan tarifa e ujit shkon në 50 lekë/m3 për familjarët duke u rritur me 13 lekë/m3, ndërsa për bizneset rritja është me 15 lekë/m3, duke shkuar në 110 lekë/m3. Ndërkaq, në Delvinë tarifa është rritur me 10 lekë për familjarët dhe 20 lekë për bizneset. Por, paralelisht me këto qytete edhe 10 aplikime të tjerë janë në shqyrtim nga Enti Rregullator i Ujit.



PHILIP MORRIS ALBANIA Shpk

Njofton se duke filluar nga data 09 Prill 2019 çmimi maksimal i shitjes me pakicë për 1 paketë për produktet e mëposhtme të duhanit me ngrohje është si vijon:

Nr	Përshkrimi i Produktit	Çmimi prej datës 09.04.2019 (përfshirë TVSH-në)
1	HEETS (AMBER LABEL)	320 Lekë/paketë
2	HEETS (BRONZE LABEL)	320 Lekë/paketë
3	HEETS (TURQUOISE LABEL)	320 Lekë/paketë
4	HEETS (YELLOW LABEL)	320 Lekë/paketë

Njoftimi bëhet në përputhje me Udhëzimin nr. 2, datë 28.1.2010 të Ministrisë së Financave "Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 17, datë 13.5.2008 'Për tatimin mbi vlerën e shtuar'" (i ndryshuar).

PHILIP MORRIS ALBANIA Shpk

Rr. Murat Toptani i, Qendra e biznesit Eurocol, Kati i 10,
1000 Tirana, Albania
Tel: +355 42 276 670



info@primall.al

www.primall.al

Shoqëria PRIMALL shpk, distributor i autorizuar për Shqipërinë e markave të kompanisë ndërkombëtare "JT International", njofton mbi çmimin e produktit të ri që do të tregtohet duke filluar nga data 15/04/2019 i cili është si më poshtë

Marka	Çmimi përfundimtar me date 15 Prill (TVSH e përfshirë)
Winston XStyle Silver Long	230

Njoftimi bëhet në përputhje me udhëzimin Nr.6 date 30/01/2015 të Ministrisë së Financave "Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë" (i ndryshuar)

Rr. Ibrahim Rugova
Pallati Kontakt nr.10, kati 4
1000 Tirana, Albania
t. +355 44 500 909
f. +355 44 500 910

Ministri Lleshaj, takim në Elbasan: Do godasim grupet kriminale në çdo cep të vendit

Shkatërrohet grupi kriminal që shpërndante kokainë në Tiranë, Elbasan e Fier, 6 në pranga

Operacioni, sekuestrohet 0.5 kg kokainë, mes të arrestuarve edhe Klajdi Gjeci, mik i Shullazit

ELBASAN

Një operacion anti drogë u ndërmor dje nga Policia e Shtetit në Elbasan dhe në Tiranë, ndërsa u arrestuan 6 persona, mes të cilëve edhe një anëtar i grupit të Shullazit, Klajdi Gjeci dhe dy anëtarë të grupit të Çapjave. Ndërkohë që janë vënë nën hetim në gjendje të lirë dhe tre persona të tjerë. Mësohet se gjatë këtij operacioni kanë përfunduar në pranga shtetasit: Klaudivo Faik Trunço, Agron Ali Qafa, Skënder Ilir Pëllumbi, Lavdosha Iljaz Demaj, Lorencio Ardian Gjini si dhe Klajdi Ndue Gjeci. Ndërsa po hetohen në gjendje të lirë Armand Shpëtim Llapo si dhe dy gra me iniciale O.O.O dhe A.A.F. Gjatë aksionit të zhvilluar u sekuestrua 550 gr kokainë. Burime policore bënë me dije se dyshohet që ky grup i strukturuar kriminal që u godit ditën e djeshme shpërndante kokainë në Tiranë, Elbasan dhe Fier. Konkretisht, pohohet se Gjeci shpërndante drogë në lagjet kryesore të kryeqytetit, ku përfshihen Tirana e Re, Stadiumi Dinamo dhe zona e Bllokut. Të njëjtat burime u shprehën Lavdosha Demaj, i cili është kreu i një grupi seksioni të PD-së në Elbasan ka në pronësi një lokal në lagjen Shënkoll, ku edhe është bërë shkëmbimi i kokainës. Nga verifikimet e kryera, bëhet e ditur se Demaj ka qenë i dënuar edhe më parë për trafik droge. Gjithashtu, burimet e mësipërme pohuan se ky grup, i drejtuar nga Agron Qafa ishte nën vëzhgim prej katër muajsh dhe se gjatë kësaj periudhë policia ka mjaftueshëm prova si: foto dhe përgjime që implikojnë këtë grup. Arrestimi i personave të mësipërm përfundoi që të çojë në zbardhjen e disa ngjarjeve të rënda kriminale të ndodhura në Elbasan dhe disa qytete të tjera të vendit. Ndërkaq, policia ka shtrirë hetimet edhe në persona të tjerë të dyshuar si pjesë e trafikut të drogës, të cilët merreshin me shpërndarjen dhe shitjen e kokainës.



Kokaina e sekuestruar gjatë operacionit të djeshëm



Arrestuari Klajdi Gjeci



Ministri Lleshaj gjatë takimit në Elbasan

PERSONAT E ARRESTUAR GJATË OPERACIONIT

1. Agron Ali Qafa
 2. Klaudivo Faik Trunço
 3. Skënder Ilir Pëllumbi
 4. Lavdosha Iljaz Demaj
 5. Lorencio Ardian Gjini
 6. Klajdi Ndue Gjeci
- NËN HETIM NË GJENDJE TË LIRË
1. Armand Shpëtim Llapo
 2. O.O.O
 3. A.A.F.

tiviteti i tyre i paligjshëm. Forca e ligjit do t'i godasë organizatat kriminale njëra pas tjetrës duke i dërguar para Drejtësisë" ka thënë Lleshaj. Në përfundim të takimit mes Lleshajt, Veliut, prefektit të Elbasanit dhe përfaqësuesve kryesorë të

organeve ligjzbatuese është arritur në përfundimin se puna e të gjithëve do t'i shërbejë rritjes së parametrave të sigurisë së jetës së qytetarëve si dhe rritjes së zbulueshmërisë dhe goditjeve të forta ndaj krimit dhe kriminelëve.

GODITJA E GRUPEVE KRIMINALE

Ministri i Brendshëm, Sandër Lleshaj sipas burimeve konfidenciale ka kërkuar nga drejtuesi i sapolëmëruar i Drejtorisë Vendore të Policisë së Elbasanit që trupa profesioniste që ai ka në dispozicion të inkurajohet për të qenë në lartësinë maksimale në kryerjen e detyrës. Ai ka deklaruar se Policia e Shtetit do të shkatërrtojë pa mëshirë aktivitetin e të gjitha grupeve kriminale në çdo cep të Shqipërisë duke i dhënë fund të gjitha spekulimeve se krimi ka mbështetje politike.

e arrestuar: LLESHAJ NË ELBASAN

E ndërsa po zhvillohej operacioni antidrogë që çoi në shkatërrimin e grupit të strukturuar kriminal, drejtuesit e organeve ligjzbatuese në vend zbardhuan në qytetin e Elbasanit, Ministri i Brendshëm, Sandër Lleshaj, kreu i SHISH, Drejtori i Përgjithshëm i Policisë, Ardi Veliu, drejtuesja e Prokurorisë së Elbasanit, drejtuesit e Drejtorisë Vendore Elbasan zhvilluan një takim me prefektin, Gledian Llatja. Në temën e diskutimit të tyre përveç ruajtjes së rendit dhe sigurisë ishte dhe goditja e aseteve pasurore të përfutur nga krimi. Në takimin e zhvilluar mes tyre është diskutuar me shqetësim dhe përgjegjësi rreth situatës aktuale të rendit dhe qetësisë publike në Qarkun e Elbasanit si dhe për marrjen e masave të menjëhershme për t'u dhënë goditjen fatale të

gjitha organizatave kriminale si dhe të gjitha figurave të krimit që vepronë në territor. Ministri i Brendshëm, Sandër Lleshaj sipas burimeve konfidenciale ka kërkuar nga Drejtuesi i sapolëmëruar i Drejtorisë Vendore të Policisë së Elbasanit që trupa profesioniste që ai ka në dispozicion të inkurajohet për të qenë në lartësinë maksimale në kryerjen e detyrës. Ai ka deklaruar se Policia e Shtetit do të shkatërrtojë pamëshirë aktivitetin e të gjithë grupeve kriminale në çdo cep të Shqipërisë duke i dhënë fund të gjitha spekulimeve se krimi ka mbështetje politike. "Pavarësisht ngjarjeve të rënda të ndodhura në Elbasan dhe gjetkë, policia është duke punuar dhe rezultatet jo vetëm që nuk do të mungojnë, por do të jenë spektakolare. Me qytetin e Elbasanit janë të lidhura mjaft fije të organizatave kriminale në Shqipëri të cilat janë identifikuar dhe që ju është dokumentuar ak-

Morën peng lushnjarin për borxhin, arrestohet i riu, në kërkim bashkëpunëtori

TIRANË - Policia e Shtetit ka arritur të lirojë një person të marrë peng prej 4 ditësh nga dy persona në Fushë-Krujë për motive përfitimi material. Operacioni i koduar "Plugu" është organizuar dhe ndjekur me metoda speciale të hetimit, nga Njësia për Hetimin e Krimeve ndaj Personit në Departamentin e Policisë Kriminale. Burime për "GSH" bënë me dije se bëhet fjalë për një 29-vjeçar nga Divjaka, për këtë arsye, operacioni është finalizuar në bashkëpunim me Drejtorinë e Forcës së Posaçme Operacionale, pas përdorimit të metodave speciale të hetimit, u finalizua operacioni policor "Plugu". Si rezultat u bë i



Fier. Nga Njësia për Hetimin e Krimeve ndaj Personit dhe Pasurisë në Drejtorinë Qendrore në Departamentin e Policisë Kriminale, në bashkëpunim me Drejtorinë e Forcës së Posaçme Operacionale, pas përdorimit të metodave speciale të hetimit, u finalizua operacioni policor "Plugu". Si rezultat u bë i

mundur arrestimi i 2-vjeçarit Edison Mjeka, banues në Nikel si dhe u shpall në kërkim bashkëpunëtori i tij, B.XH. Të dy këta shtetas prej 4 ditësh kanë mbajtur peng në zonën e Fushë Krujës për motive përfitimi material (për një borxh 4000 euro), shtetasin B.Z., i cili u lirua pa pasojë gjatë operacionit policor. Policia vijon punën për kapjen e bashkëpunëtorit të shpallur në kërkim. Materialet në ngarkim të autorëve, i kaluan Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Për Krime të Rënda Tiranë, për veprën penale të "Rrëmbimi ose mbajtja peng e personit".

Administrativja rrëzon ekzistencën e dokumenteve autentike të ish-Sigurimit të Shtetit për prokurorin

TIRANË

Gjykata Administrative vendosi dje të pranojë padinë e Bujar Sheshit ndaj Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit, që thotë se ky i fundit rezultoi të ketë qenë bashkëpunëtori i sigurimit. Ndërsa, Administrativja hoqi poshtë raportin e përgatitur vjen edhe reagimi i AIDSSH, që thotë se kundërshton vendimin e gjykatës. Në reagim thuhet se Bujar Sheshi "figuron si bashkëpunëtori i ish-Sigurimit të Shtetit në dy dokumente themeltare dhe autentike të arkivave të ish-Sigurimit dhe kjo është arritur të provohet në gjykatë, me prova dhe fakte të pakundërshtueshme, të paraqitura nga AIDSSH, me gjithë pretendimet e avokatit të Sheshit që nuk bëjnë fjalë për të njëjtin person". Por gjyqtari vendosi të pranojë padinë e ngritur nga prokurori Bujar Sheshi ndaj Autoritetit të Informimit mbi Dosjet e Ish-Sigurimit të Shtetit, AIDSSH, për shfuqizimin e aktit administrativ që e cilëson anëtarin e Këshillit të Lartë të Prokurorisë si "bashkëpunëtor" dhe "anëtar" të ish-Sigurimit të Shtetit. AIDSSH sqaron ndër të tjera se, vendimi i marrë sot ishte "i padrejtë, i pabazuar dhe i pakuptueshëm, sidomos kur rrëzon ekzistencën e dokumenteve autentike të ish-Sigurimit të Shtetit për shtetasin Bujar Sheshi".

DEKLARATA E PLOTE E "DOSJEVE"
Sot, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë, në përfundim të shqyrtimit të çështjes, ka vendosur Pranimin e Padisë së paraqitur nga z. Bujar Sheshi me objekt Shfuqizimin e Vendimit nr. 12, datë 22.01.2019, të

Gjykata: Bujar Sheshi josigurims. Autoriteti i Dosjeve: Kemi prova

Reagon AIDSSH: Vendimi ishte i padrejtë dhe i pabazuar



Bujar Sheshi

Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e Ish-Sigurimit.

Gjatë seancave gjyqësore të zhvilluara, nga pala e Paditur Autoriteti për Informimin, janë paraqitur prova dhe fakte të shumta të cilat provojnë qëndrimin e Autoritetit, të mbajtur në Vendimin nr. 12, datë 22/01/2019, sipas të cilit është vendosur se:

a) Z. Bujar Sheshi (Shesha), i datëlindjes 15.12.1957, vendlindja Tiranë, në kuptim të nenit 3 pika 4 dhe nenit 29, pika 2, germa c, të Ligjit 45/2015, "Për të Drejtën e Informimit për Dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë", figuron në dokumente të ish-Sigurimit të Shtetit si bashkëpunëtor, Sektori V, drejtimi Inteligjencë - Rini, por nga verifikimet e deritanishme nuk disponojmë dokumente që të vërtetojnë aktivitetin e tij.

b) Z. Bujar Sheshi, sipas Nenit 29, pika 2, germa c, të Ligjit nr.45/2015, "Për të Drejtën e Informimit për Dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë", figuron në këtë materiale, në emër të tij, në dokumente të ish-Sigurimit të Shtetit, si anëtar, me detyrë Hetues, në Sektorin e Hetuesisë së Degëve të Punëve të Brendshme të Fierit që nga viti 1979.

Sipas vendimit të sipërmendur, z. Bujar Sheshi figuron si bashkëpunëtor i ish-Sigurimit të Shtetit në dy dokumente themeltare dhe autentike të arkivave të ish-Sigurimit dhe kjo është arritur të provohet në gjykatë, me prova dhe fakte të pakundërshtueshme, të paraqitura nga AIDSSH, me gjithë pretendimet e avokatit të Sheshit që nuk bëjnë fjalë për të njëjtin person.

Mbështetur në Nenin 5 pika 1 të ligjit 45/2015, "Për të Drejtën e Informimit për Dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë", "Autoriteti mbledh, ruan, administron dhe përdor dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit, sipas këtij ligji, duke përdorur, sipas nevojës, edhe informacionet nga regjistri zror i gjendjes civile".

Sa më sipër, mbi këtë bazë ligjore, por jo vetëm, Autoriteti ushtroi funksionet e veta duke iu drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile, për informacion më të plotë për të saktësuar nëse ka persona të tjerë me këtë identitet apo gjenralitete të përafërta me të, si Bujar Ramis Sheshi ose Shesha, në përputhje edhe me Formularin e aplikimit të plotësuar nga vetë kërkuesi, apo Bujar Rasim Shesha, sipas dokumenteve të sipërcituar.

Nga përfaqësuesit e AIDSSH-së dhe Avokaturës së Shtetit është argumentuar në gjykatë, përmes dokumenteve arkivore shtesë, se lidhja e tij me strukturat e ish-Sigurimit të Shtetit ka filluar që në kohën e diplomimit të tij në profilin Sigurim, emërimin si "Oficer" dhe më pas "Hetues" në Degën e Punëve të Brendshme.

VETINGU

Komisioni i Pavarur i Kualifikimit ka konfirmuar në detyrë prokurorin e Apelit për Krimet e Rënda, Bujar Sheshin. Sipas KPK, Bujar Sheshi e ka kaluar procesin e vetingut, pasi nuk janë konstatuar probleme. KPK konstatoi se nga hetimi i bërë në vitin 2003, prokurori nuk ka pasur detyrim ligjor të përshkruant në formular burimin e shpenzimeve të kryera.

Provat e paraqitura nga AIDSSH, përfshirë aktet administrative të brendshme, të strukturave të ish-Sigurimit të Shtetit, kanë vërtetuar lidhjen dhe bashkëpunimin e pakundërshtueshëm të hetuesisë me strukturat e ish-Sigurimit të Shtetit. Këtë e dinë më së miri sidomos ata fatkeqë që kaluan kalvarin e dënimeve politike nëpër qeliet e hetuesive dhe familjarët e tyre, dosjet e të cilëve ruhen dhe administrohen pranë arkivit të AIDSSH-së.

Për sa më sipër, jemi të bindur se Vendimi i marrë sot nga një gjykatës i Gjykatës Administrative për të hedhur poshtë vendimin e një institucioni të specializuar dhe kolegial, është i padrejtë, i pabazuar dhe i pakuptueshëm, sidomos kur rrëzon ekzistencën e dokumenteve autentike të ish-Sigurimit të Shtetit për shtetasin Bujar Sheshi (Shesha), paraqitur në pikën 1a) të vendimit nr. 12 datë 22.01.2019.

Gjykatësi duhet të kishë vendosur lënin në fuqi të Vendimit nr. 12 datë 22.01.2019 të AIDSSH-së dhe rrezimin e padisë, si të pambështetur në ligj dhe në prova.

Për më tepër, ky vendim ka lidhje drejtpërsëdrejti me organet më të larta të drejtësisë, që të jenë të besueshme për publikun.

AIDSSH është e vendosur ta apelojë vendimin në Gjykatën Administrative të Apelit, e bindur se interesi publik prevalon mbi atë individual, në emër të transparencës dhe konsolidimit të demokracisë.



REPUBLIKA E SHQIPERISE
BANKA E SHQIPERISE
DEPARTAMENTI I ADMINISTRIMIT
SEKTORI I PROKURIMIT

TENDER I HAPUR KOMBËTAR

Banka e Shqipërisë kërkon të realizojë objektin e prokurimit: "Blerje pajisje dhe aksesore për zonat e sigurisë për nevojat e Bankës së Shqipërisë"

"Banka e Shqipërisë fton kandidatët e interesuar, të marrin pjesë në procedurën e prokurimit "Tender i hapur kombëtar", për realizimin e objektit të prokurimit si më sipër, me **fond limit 4,900,000 Lekë**".

Dokumentet e tenderit mund të tërhiqen pranë Sektorit të Prokurimeve të Departamentit të Administrimit, të Bankës së Shqipërisë, me adresë: Rruga e Dibrës, Kompleksi "Halili", Kulla A, Tiranë, Tel. 042419411 (ext. 1844), çdo ditë nga çdo person i autorizuar, me paraqitjen e një kërkesë me shkrim. Tërheqja e dokumenteve mund të bëhet vetëm pasi të keni bërë paraprakisht pagesën e pakthyeshme prej 500 Lekë, pranë një banke tregtare në llogarinë e Bankës së Shqipërisë sipas detajeve të mëposhtme:

Përfutuesi: Banka e Shqipërisë
BIC: STANALTR
IBAN: AL68 1011 1008 0000 0000 2222 222L; BIC

Përkshkrimi: Blerje dokumente tenderi për tenderin me objekt: "Blerje pajisje dhe aksesore për zonat e sigurisë për nevojat e Bankës së Shqipërisë"

Oferta duhet të paraqitet në zyrën e Sektorit të Prokurimeve, pranë Departamentit të Administrimit, në Bankën e Shqipërisë, deri më datë 08 Maj 2019, ora 11:00, kohë në të cilën do të hapet edhe tenderi, ku ftohen të marrin pjesë kandidatët ose përfaqësuesit e autorizuar të tyre.



REPUBLIKA E SHQIPERISE
BANKA E SHQIPERISE
DEPARTAMENTI I ADMINISTRIMIT
SEKTORI I PROKURIMIT

TENDER I HAPUR KOMBËTAR

Banka e Shqipërisë kërkon të realizojë objektin e prokurimit: "Blerje e suportit vjetor të produkteve Cisco"

"Banka e Shqipërisë fton kandidatët e interesuar, të marrin pjesë në procedurën e prokurimit "Tender i hapur kombëtar", për realizimin e objektit të prokurimit si më sipër, me **fond limit 5,466,000 Lekë**".

Dokumentet e tenderit mund të tërhiqen pranë Sektorit të Prokurimeve të Departamentit të Administrimit, të Bankës së Shqipërisë, me adresë: Rruga e Dibrës, Kompleksi "Halili", Kulla A, Tiranë, Tel. 042419411 (ext. 1844), çdo ditë nga çdo person i autorizuar, me paraqitjen e një kërkesë me shkrim. Tërheqja e dokumenteve mund të bëhet vetëm pasi të keni bërë paraprakisht pagesën e pakthyeshme prej 500 Lekë, pranë një banke tregtare në llogarinë e Bankës së Shqipërisë sipas detajeve të mëposhtme:

Përfutuesi: Banka e Shqipërisë
BIC: STANALTR
IBAN: AL68 1011 1008 0000 0000 2222 222L; BIC

Përkshkrimi: Blerje dokumente tenderi për tenderin me objekt: "Blerja e suportit vjetor të produkteve Cisco"

Oferta duhet të paraqitet në zyrën e Sektorit të Prokurimeve, pranë Departamentit të Administrimit, në Bankën e Shqipërisë, deri më datë 07 Maj 2019, ora 11:00, kohë në të cilën do të hapet edhe tenderi, ku ftohen të marrin pjesë kandidatët ose përfaqësuesit e autorizuar të tyre.

EKSPOZITA

Portrete fëmijësh të kthyer, fotografi që fuqizojnë

Fatmira Nikolli

Fëmijë të qeshur ndonëse je tojnë në kushte të vështira. Portrete të çelura e plot jetë. Të kthyer nga vendet ku familjet e tyre patën emigruar, ata ripërballen me jetën që kanë lënë pas dhe me mjerimin prej të cilit ikën. "Terre des hommes" në bashkëpunim me Universitetin e Arteve ka çelur të enjten punimet e fotografës Malavika Sattler dhe punimet e studentëve të Universitetit të Arteve. Kjo ekspozitë synon të pasqyrojë se si arti mund të përdoret nga të rinjtë dhe fëmijët për të sjellë ndryshim për çështje që e lidhen me ta dhe si ndikon në fuqizimin, zhvillimin dhe përfshirjen e tyre. Në qendër janë punime të studentëve me fëmijë të kthyer nga emigracioni, ndërsa Malavika Sattler ka bërë praktikën në Terres des Hommes duke ndjekur aktivitetet e Terres des Hommes në Shqipëri si vullnetare. Kësajsoj e ardhur nga Austria ajo ka qenë në Shkodër, Lezhë e Fier dhe ka vënë re që fëmijët arrijnë të rigjejnë gezimin.

E pyetur nga "GSH" për këtë përvojë, Sattler tha se "portretet janë të qeshura" duke lënë të kuptojnë se për fëmijët nuk ka rëndësi ku janë. "Kam qenë për më shumë se një muaj me këta fëmijë. Në fillim ishte pak shokuese për mua dhe më dukej vetja si ajo vëzhguesja që iu futej në shtëpinë të tyre dhe i vështronte. Por për ata me kalimin e kohës kuptova se kjo ishte një gjendje normale dhe nuk e kishin fare problem praninë time ose faktin që i fotografoja. Ndaj fillova të ndihesha mirë dhe shumë rehat me ta kudo që i takoja".

Shpesh e ardhmja varet nga familja ku lindin, nga ngjyra jonë

Malavika Sattler: Pas kësaj përvoje, mendoj se duhet të ndryshojmë diçka në botë



e lëkurës, nga besimi fetar që marrim nga familja, nga kultura e nga shteti ku lindim. E ardhur nga Eruopa për t'u përballur me këta fëmijë, ky zbulim për Malavikën ishte mbase një lloj thyerje.

"Unë mendoj se një fëmijë nuk i bën këto dallime. Në fillim nuk do t'ia dijtë për këto. Do të jetë i lum-

tur dhe është i lumtur kur është më familjen e me shokët. Me kalimin e kohës, nisin paragjykimet e dallimet. Nuk e di se si jam ndjerë, por di vetëm atë që pas kësaj përvoje më ka zënë një ndjesi përgjegjësie që duhet të ndryshojë diçka në këtë botë dhe besoj kjo duhet bërë", tha ajo të enjten për



bën ndryshimin. Fëmijët mendojnë se kjo është normale. Shohin televizor, por nuk kuptojnë çfarë është reale e çfarë jo dhe në një pikë e kupton se ka disa mënyra jetese. Fëmijët janë të lumtur, sepse nuk i dinë gjërat", tha Sattler.

Kjo ekspozitë, e titulluar 'Terre des enfants' (Toka e fëmijëve), e cila vjen si bashkëpunim midis 'Terre des hommes' dhe Universitetit të Arteve pasqyron punimet nga fotografa Malavika Sattler dhe punime nga studentët e Universitetit të Artit, synon të pasqyrojë se si arti mund të përdoret nga të rinjtë dhe fëmijët për të sjellë ndryshim për çështje që lidhen me ta, dhe si ndikon në fuqizimin, zhvillimin dhe përfshirjen e tyre. Pas kthimit në Shqipëri, fëmijët, të rinjtë dhe familjet ndeshen me një sërë sfidash dhe vështirësish. Për të lehtësuar procesin e riintegritimit, 'Terre des hommes' nëpërmjet ndërhyrjeve të integruara mbështet fëmijët, të rinjtë dhe familjet e tyre të rimëkëmben nga ana sociale dhe ekonomike. Qendrat multifunktionale për fëmijët luajnë një rol të madh në këtë detyrë. Arti merr një domethënie tjetër kur kombinohet me ndërhyrje sociale në këto qendra duke qenë ndërmenytrat më efektive dhe të fuqishme të ndikimit.



"Gazeta Shqiptare".

Kur e pyes nëse vetëm kur jemi fëmijë ndihemi të barabartë me të tjerët sepse vetëm atëherë nuk i kuptojmë ndryshime, ajo përgjigjet me po. "Mendoj se po. Në një farë moshe nis të kuptosh më shumë rreth botës dhe kur sheh më shumë rreth botës, nis e bën dallimin. Kur je i vogël nuk i lexon gazetat, nuk e sheh si jetojnë njerëzit e tjerë dhe kjo mendoj se

ARKEOLOGJIA

SIMPOZIUMI "ILIRIA E JUGUT DHE EPIRIT NË ANTIKITET"

Instituti i Arkeologjisë pranë Akademisë së Studimeve Albanologjike, në bashkëpunim me Universitetin Lyon 2 Lumière dhe Ambasadën e Francës në Tiranë, prezantuan botimin e akteve të konferencës së VI-të ndërkombëtare: "Iliria e Jugut dhe Epirit në antikitet". "Iliria e Jugut dhe Epirit në antikitet" është simpoziumi i gjashtë, që organizohet që prej vitit 1984. I pari është mbajtur në Clermont-Ferrand (Francë) me iniciativën e P. Cabanes, i fundit në Grenoble (Francë), në tetor 2008. Çdo gjashtë vjet, kjo veprimtari e rëndësishme bën bashkë gjithë komunitetin shkencor që punon në Ballkan, me kërkime që shtrihen nga periudha para dhe proto-historike, deri në mesjetën e hershme bizantine. "Iliria e Jugut dhe Epirit në antikitet" është simpoziumi i vetëm në këtë fushë dhe bashkon studiues nga vendet e Ballkanit, studiues evropianë dhe amerikanë që punojnë në projektet ndërkombëtare. Rëndësia e botimit të akteve është e dyfishtë. Së pari, bëhen të njohura zbulimet e fundit në fushën e arkeologjisë, epigrafisë dhe numizmatikës. Në të vërtetë, që me



nisjen e projekteve ndërkombëtare në Shqipëri, tashmë edhe në Kosovë, dhe duke marrë parasysh zhvillimin e konsiderueshëm të hulumtimit në Greqinë veriperëndimore, në veçanti përmes metodës së syrvey-t, ritmi i zbulimeve në këto zona është përshpejtuar. Në këto kushte është e rëndësishme që rezultatet të balafaqohen me komunitetin shkencor, në një perspektivë të shumëfishitë histori-

ografike dhe ndërdisiplinore. Së dyti, paraqiten përmbledhje historike në një fushë specifike, që në rastin e Iliria e Jugut dhe Epirit në antikitet VI është ajo e qyteteve, territoreve, popullsisve dhe dinamikës mjedisore. Kjo zgjedhje u kushtëzua nga tematikat e hulumtimeve që realizohen nga ekupe të ndryshme, përfshirë këtu dhe studentët të doktoraturës. Në fakt, konferenca u kr-

ijoi mundësinë doktorantëve që të paraqisin punimet e tyre. Konfrontimi mes përvojës së akumuluar nga studiuesit e vjetër dhe rinovimi i tematikave të propozuara nga hulumtuesit e rinj, ka dëshmuar në simpoziumet e fundit se është një kombinimi i duhur për një kërkim shkencor dinamik dhe të suksesshëm. Studiuesit e rinj u paraqitën me më shumë se tridhjetë postera, çka dëshmon për dinamizmin e tyre. Nga ana tjetër, kuadri kronologjik nga prehistoria deri në periudhën bizantine, mundëson një sqarim më të mirë të proceseve transformuese që kanë ndodhur në këto rajoneve përgjatë shekujve, duke i lejuar të gjitha disiplinat e shkencave të antikitetit të japin kontributin e tyre. Suksesi i këtyre takimeve matet nga numri në rritje i vendeve të përfaqësuar dhe i kolegëve që dëshirojnë të paraqesin rezultatet e kërkimeve. Në botimin e akteve të simpoziumit të VI-të, janë përfaqësuar 12 shtete me mbi 130 studiues. Duhet theksuar fakti se për herë të parë, në traditën e kësaj veprimtarie shkencore, ajo u zhvillua në një vend ballkanik, gjë që inauguron një traditë që duhet të konsolidohet.

BLUE TOOTH

Thashetheme
MADE IN ALBANIA

Nr. 656

SUPLEMENT I PERJAVSHEM GAZETA SHOIPTARE Redaktore: Pamela Allaj - Art Designer: Nevila Samarxhi

E shtune 13 Prill 2019

ISLI ISLAMI:

MARRËDHËNIA MË ORI NEBIJAJ, PUBLIKU E KA KUPTUAR SAKTË APO E KA KEQKUPTUAR?



Rrëfëhet moderatori: Ndjehem i përkëdhelur nga reagimet e publikut femëror.
"Harxhojmë kohë lart e poshtë në vend që të rrimë me personin e zemrës"

Ndahet pas 10 vitesh lidhje?

RIKE ROÇI: Ja si qëndron e vërteta



PËR HERË TË PARË SE BASHKU


Zbulohet projekti ku do shfaqen Turi dhe Orinda



- NË HAPAT E PRINDËRVE, VAJZA E TEUTËS DHE BLEROS SJELL ALBUMIN E PARË
- PROVOKON SËRISH! FLORI TËRHEQ VËMENDJEN PËR ROMANCËN ME KEJSI TOLËN
- JO VETËM REPER I SUKSESSHËM, POR EDHE DJALË PËR SHTËPI, JA PASIONI I RI I NOIZYT

Në hapat e prindërve, vajza e Teutës dhe Bleros sjell albumin e parë

Vajza e vetme e artistëve shqiptarë Blero dhe Teuta, Tara është në përgatitje të albumit të saj të parë muzikor. Të paktën kështu e ka bërë të ditur këngëtarin Blero, i cili ka postuar një fotografi të Tarës duke inçizuar në studio. Ndërsa ai ka shkruar se janë duke inçizuar albumin e saj të parë, ndërsa natyrisht që producent është vet ai. Ndërkohë që nëna e saj, aktorja Teuta Krasniqi ka treguar në disa intervista Tara ka dëshirë të merret me art, dhe se do jetë zgjedhja e saj nëse në të ardhmen do merret me muzikë ose aktrim, ose mbase me të dyja.




Poston foto nga fëmijëria, aktori shqiptar i bën dedikim vetes

Ai është një nga aktorët më tërheqës shqiptar, i cili prej 10 vitesh jeton në Gjermani aty ku dhe punon. Pasionin e tij për aktrimin Blerim Destani, e ka zbuluar që në moshën 14-vjeçare kur iu dha roli i tij i parë në filmin 'Atje ku nuk lind dielli'. Ditën e djeshme Destani feston ditëlindjen e tij të 38-t dhe këtë e ka treguar për të gjithë ndjekësit e tij në 'Instagram', duke publikuar një foto nga fëmijëria e tij bashkangjitur së cilës ka shkruar: "I numëroj vitet e mia nga dashuria e familjes, miqve, momenteve dhe buzëqeshjeve. Faleminderit për urimet, gjithë të mirat për ju". Kujtojmë se Blerimi ka publikuar rrallëherë imazhe nga fëmijëria dhe ka zgjedhur këtë ditë të veçantë për t'i shprehur të gjithë të afërmeve të tij mirënjohjen për çdo gjë.


Për herë të parë së bashku, zbulohet projekti ku do shfaqen Turi dhe Orinda

Ata prej kohësh janë bërë pjesë e stafit të 'Tv Klan'. Turjan Hysko drejton emisionin argëtues 'Familja', ndërsa Orinda Huta është moderatore e 'Jo vetëm modë'. Së fundmi mediat rozë kanë zbuluar se Orinda do të drejtojë festivalin operistik 'Marie Kraja'. Mesa duket, moderatorja nuk ka ndërmend të ndalojë me kaq. Turi lajmëroi fansat e tij ditën e djeshme për projektin më të ri në emisionin 'Familja', i cili duket se do të drejtohet nga bashkëshortja e tij. Bëhet fjalë për një biletë të re që quhet 'Porta e Fatit', pjesë e 'Lotaria Kombëtare' që transmetohet tek emisioni që Turi drejton. Moderatorin bën të ditur se çdo javë do të fitohen apartamente, makina dhe para. Shumë surpriza pritet të shohim nën moderimin e çiftit.



Jo vetëm reper i suksesshëm, por edhe djalë për shtëpi, ja pasioni i ri i Noizyt

Ai është padyshim një nga reperët më të njohur shqiptarë, por, mesazhi duket, muzika nuk është gjëja e vetme që ai di të bëjë mirë. Së fundmi, ai ka publikuar disa foto në 'Instastory' ku tregojnë me hapa se si ka filluar përgatitjen e patëllxhanëve të mbushur, e deri në përfundimin e gatimit. Kjo nuk është hera e parë që Noizyt ka treguar se ka një pasion për kuzhinën dhe pavarësisht se udhëton gjatë gjithë kohës, duket se ai preferon të ushqehet me gjëra të shëndetshme në vend të 'Fast Food-eve'. Pra, përveç se një reper i suksesshëm ai është edhe një kuzhinier fantastik!




Bebe Rexha do sjellë albumin e ri, e frymëzoi Britney Spears

Pas këngës së fundit të Bebe Rexhës, 'Last Hurrah', u komentua dhe u pëlqye shumë në të njëjtën kohë. Së fundmi, këngëtarja shqiptare lajmëroi fansat e saj në 'Twitter' se kishte gati 12 këngë të reja dhe po mendonte të publikonte një album. Ajo, gjithashtu, tha se albumi do të jenë 'himni i kërcimit' dhe do të inspironet nga kënga 'Toxic' nga Britney Spears. Ky lajm është pritur shumë mirë nga fansat e saj dhe ashtu si vetë Bebe, të gjithë janë shumë të emocionuar. Pas suksesit të këngës së saj të fundit, me siguri dhe albumi i saj i ri do të jetë i tillë. Me siguri do të jetë sukses ashtu si dhe të mëparshmit e Bebes.



Ava Max performoi tek Ellen Show, sikleti në performancë dukej sheshit

Ava Max është një tjetër vajzë shqiptare që pritet të shpërthejë në Abotë si Rita Ora, Dua Lipa a Bebe Rexha. Ndërkaq ditën e enjte, Ava pati fatin të performojë në "The Ellen Show," një mundësi e jashtëzakonshme për t'u ekspozuar ndaj fansave të rinj. Ajo u prezantua nga Mila Kunis dhe këndoi hitin masiv, "Sweet but Psycho." Nuk ishte keq, por mund të ishte shumë më mirë. Së pari, Ava njihet për modelin asimetrik të flokëve. Kur themi asimetrik, e kemi fjalën për një anë të shkurtër dhe të drejtë, një anë të gjatë dhe me onde. Kjo lloj estetike u ndoq edhe për veshjen e saj, me njërën anë të mbuluar e tjetrën të zbuluar. Ngaqë duket çuditshëm, komentuesit e krahasuan me Lady Gaga-n, fjalë për fjalë si një version inferior i Lady Gaga. Ava pati probleme dhe me vokalin në skenë, ndoshta nga emocionet, ndoshta nga mungesa e provave. Edhe kjo iu vu në pah nga komentuesit nën videon e publikuar në YouTube. Ajo që u vu re gjithashtu ishte që këngëtarja s'kishte prezencë në skenë, ndihej në siklet dhe këtë e transmetonte dhe në ekran. Por një sjellje e tillë është e mirëkuptueshme duke qenë se është thjesht fillimi i karrierës për Ava Max. Suksese dhe skena më të mëdha do të pushtojnë në të ardhmen këngëtarja shqiptare.



Këngëtarja Poni surprizon fansat, zbulon projektin e ri që po përgatit

Ajo është një nga këngëtarët më të dashura të showbiz-it shqiptar, kjo për shkak të projekteve muzikore tepër të pëlqyera që ajo ka sjellë ndër vite. Së fundmi Poni ka ndarë në 'Instagram' një pyetje të cilën duket se e ka hasur shpesh këto kohë. Fansat janë kuriozë nëse Poni do të sjellë muzikë të re për ndjekësit e saj. Ajo ka pohuar se prej shumë kohësh ka marrë mesazhe të tilla, por ka menduar t'i rezervojë një surprizë më të bukur fansave duke thënë: "Ka çdo ditë pyetje të tilla dhe ju falënderoj shumë, por mungesa e gjatë ka qenë sepse doja të kisha një album me disa këngë të reja dhe jo vetëm një këngë apo klip të ri. Shihemi së shpejti të dashur miq dhe dashamirës të këngës sime". Mesa duket 36-vjeçarja ka menduar se një album i ri do ta sillte më pranë gjithë adhuruesve të muzikës së saj të cilët prej kohësh presin projekte muzikore nga Poni.



Provokon sërish! Flori tërheq vëmendjen për romancën me Kejsi Tolën

Dihet tashmë se Flor Mumajesi jo shpesh herë shpreh vlerësimet në publik për këngëtarët e njohura shqiptare, por kur e bën ndodh që të lindin fjalë për lidhje romantike mes tyre. Prej vitit të kaluar kantautori përfillet për një romancë me Kejsi Tolën, por Flori duket se gjen gjithmonë një mënyrë "për t'i hedhur benzinë zjarrit" dhe mesa duket i pëlqen t'i bëjë gjërat lëmsh. Ditën e djeshme ai përhëndeti ndjekësit e tij në 'Insta Story' me këngën e Kejsit, "Më ke mua", me të cilën ajo konkurroi në festivalin "Kënga Magjike". Fillimisht luhet hiti i tij "Plas", ndërsa Flori dëgjohej të thotë: "Okej, kënga e dytë" dhe nis pikërisht ajo e Kejsi Tolës. Postimin ai e ka shoqëruar me emoji-n e syve zemra, ndërsa është etiketuar edhe këngëtarja. Askush prej dyshes nuk ka reaguuar publikisht për lidhjen e mundshme, por kjo është një arsye më tepër të dyshojmë për diçka mes tyre, apo jo?

Pamela Aliaj

A i është një nga djemtë më simpatici të cilin e ndiqni çdo ditë teksa moderon një nga emisionet e mëngjesit në krah të Ori Nebiaj. Më parë si spiker lajmesh, tashmë prej tri vitesh si moderator i "Wake Up", Isli Islami rrëfhet për herë të parë në një intervistë ekskluzive për "Bluetooth" të "Gazeta Shqiptare", pa dorashka. Isli na tregon si është jeta e tij prapa prozhektorëve të kamerave. Duke nisur që nga pyetja klishe që do donin të dinin shumë vajza "A është dikush në jetën tënde?" apo "Kur do marthohesh" (pyetje që sipas Islit i bëhet shpesh), moderatori na rrëfen shumë elementë nga jeta e tij që nuk i dinim. Me thjeshtësinë dhe çiltërsinë që e karakterizon, Isli na tregon edhe uljet e ngritjet në jetën e tij, zhgënjimet dhe periudhën më të bukur të jetës. Po për sa i përket partneres ideale? Këto e shumë të tjera i zbuloni në intervistën e mëposhtme:

Prej shumë kohësh bashkëmoderon emisionin me Ori Nebiaj, "Wake Up". A ke menduar të nisësh diçka tjetër?

Para se të nisësh diçka të re duhet të kesh mbyllur punë me "të vjetrat". Edhe pse nuk mund të them se "Wake Up" është "vjetëruar", sepse ky është veçse sezoni i dytë i imi në bashkëmoderim me Orin dhe i treti si moderator i emisionit të mëngjesit në Top Channel. Tani, a nuk mendon se nuk janë edhe aq shumë kohë 3 vjet apo jo?


Nga spikeri i lajmeve të moderator i emisionit të mëngjesit. Ku bashkohen dhe ku ndahen këto dy pozicione të Islit në ekran?

Janë totalisht dy pozicione të ndryshme dhe ndjesitë janë larg njëra-tjetrës, edhe pse duket sikur ti je thjesht imazhi i një emisioni, produktioni apo qoftë edicioni informativ. Tek lajmet ti je figura e parë dhe personi, i cili transmeton një informacion, por vëmendja nuk ngelet tek ti gjithsesi, sepse me i rëndësishëm është lajmi. Ndërkohë, në një program, si moderator shkon paralel me përmbajtjen dhe atë se çfarë programi jep për shikuesin. Automatikisht ke një tjetër lloj përgjegjësie, pozicioni, imazhi e perceptimi. E për-



Rrëfhet moderatori: Ndjehem i përkëdhelur nga reagimet e publikut femëror

Marrëdhënia me Ori Nebiaj, ISLI ISLAMI: Publiku e ka kuptuar saktë apo e ka keqkuptuar?



"Harxhojmë kohë lart e poshtë në vend që të rrimë me personin e zemrës"


bashkëta gjithsesi qëndron tek fakti që ti je përballë një publiku i cili të do, të mbështet, por edhe të kritikon e të mëson gjithnjë e për më mirë.

Gjithmonë veten e ke parë si pjesë të ekranit apo ky takimi yt me televizionin erdhi rastësisht dhe vendose të qëndrosh?

Kjo është një ndër pyetjet më të vështira për t'iu përgjigjur. Një pjesë e imja thotë që diçka ka qenë si e përcaktuar dhe e përzgjedhur nga ana ime që fëmijë. Kam patur gjithmonë

dëshirë të jem për 1-2 orë në qendër të vëmendjes duke performuar, duke thënë apo duke treguar diçka. Por nuk e kam patur të qartë. Pastaj pas gjimnazit, gjithçka u bë si më e qartë. Me të dëgjuar që bëhej një audicion në Top Albania Radio për moderator, nuk u mendova dy herë. Shkova me vrap. Dhe pjesa tjetër është histori. Jam pjesë e medias prej më shumë se 12 vjetësh. Them se disa gjëra i zgjedhim, disa gjëra na zgjedhin.

Nëse nuk do të ishit





bërë spiker/moderator ku tjetër e sheh ti veten profesionalisht?

Do të isha një pedagog shumë i mirë i komunikimit. Mund të isha një specialist marketingu, gjithashtu. Dhe tjetra pastaj, një mendje më thotë që mund të isha bërë volejbollist shumë i mirë. Diçka mes këtyre të triave.

Keni tentuar ta provoni veten në një prej këtyre profesioneve?

Kam një eksperiencë të shkurtër në marketing, por mendoj se e kam lënë ta plotësoj si të tillë në të ardhmen.

Si beqar i ekranit besoj janë shumë propozimet që merr nga vajzat. Kujtoj se ke pasur dhe propozime publike si ai i Mariza Ikonomit, e cila në një intervistë është shprehur se do të preferonte të martohet me ty. Ke ti një model sesi e sheh partneren tënde ideale? Na e përshkruaj pak si do të ishte ajo?

Ndiheh realisht i përkëdhelur për shkak të vizibilitetit që profesioni më jep e rrjedhimisht edhe e feedback-ut që marr, kryesisht nga publiku femëror. Mariza është një prej këngëtareve më të mira që kemi dhe një vajzë tepër simpatike. Besoj se kush nuk do të donte të merrte një propozim prej saj apo në fund të ditës ta propozojte. Dhe nuk besoj i kanë munguar të tilla. Besoj, një formë vlerësimi nga ana e saj, duke qenë se jemi dhe miq. Megjithatë, shpresoj mos të ngelemi në situatën kur të na duhet të zgjedhim njëri-tjetrin si partnerë.

Nëse një ditë do ta takojë partneren tënde ideale si do ja bëjë të ditur se ajo është e duhura?

Troç e shumë shqip (ose anglisht). Jam mësuar të jem i drejtpërdrejtë në jetë, sepse ndonjëherë harxhojmë aq shumë kohë duke i rënë gjërave rreth e qark sa mund ta kishim kaluar pikërisht atë kohë të humber në krahët e personit të zemrës. Është problem i një pjesë të mirë të njerëzve, besoj.

Në përgjithësi më shumë keni zhgënjyer apo të kanë zhgënjyer?

Në përgjithësi, më shumë më kanë zhgënjyer. Jam përpjekur të mos zhgënjëj sepse nuk dua të marr përsipër lëndimin e askujt. Aq më tepër personave të dashur. Si një person që ka vuajtur nga zhgënjimi, jam munduar të mos jem shkaktar i kësaj ndjesie jo fort të mirë.

Ke krijuar një traditë që herë pas here u përgjigjesh pyetjeve të



fansave. Cila është pyetja që të bëhet aq shpesh sa kalon në bezdisje?

Pyetje-përgjigjet janë një pjesë shumë interesante dhe e këndshme e kohës që kaloj me ndjekësit e mi, të cilët realisht janë tejet të mirë e më mbështesin shumë. Është vërtet kënaqësi. Ka edhe pyetje që përsëriten shpesh herë, sepse përgjigjen mund ta kenë humber, e herë,

sepse duan të insistojnë. Ka shumë pyetje që më bëhen gjithmonë. Një prej tyre është çfarë kuptimi ka emri im, një tjetër është libri i preferuar (Harku i Triumfit, për ata që po e lexojnë intervistën, ta bëjmë të qartë një herë e përgjithmonë). Ndërkohë, pyetja tjetër për të cilën ngulmojnë një pjesë e mirë, kryesisht femrat, është "kur do martohesh". Nuk mungon

kurrë si pyetje. Ama, edhe përgjigja nuk është se ka munguar: "ka kohë plot!".

Kam vënë re se ata të pyesin shpesh dhe në lidhje me Orin nëse ka ndonjë gjë më shumë përtej miqësisë. Mendoni se ata e kanë keqkuptuar kiminë që ju keni me njëri-tjetrin apo...?

Them se e kanë keqkuptuar, ose e kanë kuptuar saktë. Mesa duket një miqësi tepër e mirë përkthehet në diçka më shumë. Pra, jemi mësuar të kemi çifte miqsh ose "të mirë", ose "bashkë". Të mesmen si popull nuk është se e preferojmë shumë. Jemi njerëz të ekstremeve në më duket.

A është kjo periudha më e bukur e jetës tënde apo më e bukura pret që të vijë?

Definitivisht, do të vijë. Jam tepër optimist dhe entuziast si natyrë.

Meqenëse jemi këtu pse gjimnazi ka qenë një ty periudha më e keqe?

E bëra publik si informacion në një mbërmje në 'Instagram' në faqen time dhe u përballa me habi të madhe nga njerëzit. Mesa duket bëj pjesë tek ata pak vetë që ia kanë kaluar keq në gjimnaz. Unë kam bërë Liceun Artistik "Jordan Misja" për violonçel, dhe në na është dashur të studiojmë shumë për të qenë në lartësinë e duhur e për të arritur rezultate të mira. Ndërkohë një ish-gjimnazist që ndoshta ndoshta është habitur me përgjigjen time, do ketë bërë më shumë qejf në kohën e tij/saj. Kemi patur shumë përgjegjësi për atë moshë delikate, e cila kërkonte më shumë dëfrim e argëtim sesa punë. Megjithatë, them se i kam marrë më të mirën e mundshme asaj periudhe, por më duhet të pranohet me sinqeritet se nuk kam aspak nostalgji për atë periudhë.

Cili është motivi që për tre vjet me radhë të zgjon mëngjes për mëngjes për të shkuar në punë?

Dëshira për të çuar përpara një punë që e bëj me pasion e përgjegjësi, si dhe dëshira për t'i dhënë publikut shqiptar, i cili është i tejngopur me njerëz jorealë, thjeshtësinë e një personazhi televiziv që në fund të ditës, përballet me të njëjtat probleme, situata, stresse por edhe gëzime si të gjithë ata që ndjekin programin tonë.

A ke ti dikë, apo një motiv që përgjithësisht të udhëheq në jetën tënde?

Po. Jezus Krishti, shpëtimtari im.



Projektet e reja në fushën e modelingut të ish-banores së “Big Brother”

Ndahet pas 10 vitesh lidhje? Reagon Rike Roçi: Ja si qëndron e vërteta

Shumë zhurmë për asgjë! Flet bukuroshja nga Durrësi për marrëdhënien me politikanin

Para pak ditësh në mediat online qarkulloi një foto e Rike Roçi, të cilën ajo e publikoi në rrjetet sociale dhe ku prezantoi mashkullin që ka fiksuar dhe tregoi se ishte dashuruar me të. Të gjithëve i krijua përshtypja se ai ishte i dashuri i Rikes, por më pas u mësua se mashkulli në fjalë ishte presidenti i lëvizjes “5 Stelle” në Itali, Luigi di Maio. Ndërkaq kujtojmë se në një nga intervistat e saj, deklaroi se sa i takon statusit, tashmë është single, duke deklaruar se është ndarë nga i fejuari i saj, Dj-i italian, Luca Binatti. Por kujtojmë se historia e saj e dashurisë nuk është si gjithë të tjerat, nga ato të zakonshmet që kur përfundojnë, nuk ka kthim pas. Fiks para një viti, ish-lojtarja më seksi e “Big Brother”, u rikthye tek ish-i dashuri legjendar, pasi e kishte deklaruar në media ndarjen, për faktin se kishte nisur një histori të re me një tjetër djalë. Por ajo që kanë thënë lartë e poshtë për një histori të mundshme me politikanin di Maio s’është aspak e vërtetë! E pyetur për “Bluetooth” të “Gazeta Shqiptare”, Rike ka deklaruar se janë të gjitha gënjeshtra dhe se nuk e ka thënë asnjëherë një gjë të tillë. Pra, të gjitha spekulimet bien poshtë! Ndërkohë nga ana tjetër bukuroshja nga Durrësi, pas pasionit të aktrimit ka nisur disa projekte të reja me kompani fotografike si Spetro, i cili merret me fotografimin e modeleve të ndryshme, ku ndër to ka qenë edhe Rike së fundmi. Këto e shumë të tjera pritet të shohim nga ish-banorja e “Big Brother” që duket se s’ka të ndalur!



BalkanWeb.com

AGJENCIA E LAJMEVE MË E KLIKUAR NË HAPËSIRËN SHQIPTARE.
LAJMET MË TË FUNDIT ME VIDEO DHE FOTO NGA VENDNGJARJA,
ANALIZA DHE TEMATIKA TË NDRYSHME, GJITHÇKA ME NJË KLIKIM.



MERRNI NE KOHE REALE LAJMET E FUNDIT NE APARATIN TUAJ
CELULAR SMARTPHONE OSE TABLET



INSTALONI APLIKACIONIN E BALKANWEB NE MOBILE DHE TABLET
KERKONI NE APPLE STORE DHE GOOGLE PLAY OSE DUKE SKANUAR
QR CODE APPLE DHE ANDROID

BalkanWeb.com
BW

FALAS



Dje në "Deutsche Welle"

Gjermania: Ballkani është detyrë e Evropës

Nga Anila Shuka

(vijon nga faqja 1)

e datës 29 prill do të priten të vijnë përfaqësues të nivelit të lartë të vendeve të Ballkanit Perëndimor. Kroacisë, Sllovenisë dhe Komisionit të BE-së. Duke shpjeguar arsyen e ftesës së kancelares Merkel dhe presidentit Macron, Seibert tha se ata dëshirojnë të flasin me "bashkëbiseduesit e tyre për sfidat e veçanta në rajon dhe në radhë të parë për stadin e dialogut Serbi-Kosovë".

Seibert nuk pranoi të thoshte asgjë për pritshmëritë ndaj kësaj konference. "Programi nuk është ende gati", tha ai duke shtuar se ky takim "është fryt i mëtejshëm i interesimit të thellë që kemi ne për zhvillimin pozitiv të Ballkanit Perëndimor".

INTERESIMI I MADH PËR RAJONIN

Si shprehje të këtij interesimi, Seibert kujtoi edhe Procesin e Berlinit, në kuadër të të cilit sot po zhvillohet edhe një takim i ministrave të Jashtëm në Varshavë. Aty merr pjesë edhe ministri gjerman i Punëve të Jashtme, Heiko Maas. Polonia do të jetë organizatore e takimit të ardhshëm në kuadër të Procesit të Berlinit, që do të mbahet më 5 korrik. Procesi i Berlinit synon me nisma në sektorin e ekonomisë, transportit dhe rinisë që të luajë një rol të rëndësishëm në përmirësimin e marrëdhënieve bilaterale ndërmjet vendeve të Ballkanit Perëndimor.

"Në takimin në fund të prillit, në Berlin nuk do të ketë përfaqësues as nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës e as nga Rusia", tha Seibert duke iu përgjigjur kështu pyetjes së "Deutsche Welle"-s.



I pyetur nga "DW" nëse është biseduar më parë edhe me Rusinë dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës për pjesëmarrje eventuale, Seibert përgjigjet: "Pari-

miisht, gjendja në Ballkanin Perëndimor është herë pas here temë në bisedat tona me qeverinë amerikane. Por, ne e ndiejmë si një detyrë në radhë të parë evropiane që ta çojmë këtë pjesë të

Evropës në një të ardhme të qëndrueshme, demokratike dhe me perspektivë evropiane".

KUFIJTË JANË TË (PA)PREKSHËM

Procesi i dialogut për normali-

zimin e marrëdhënieve mes Serbisë dhe Kosovë, i cili është një nga kushtet e anëtarësimit të Serbisë në BE, konsiderohet i ngecur në vend që nga vera e vitit të kaluar, kur presidentët e Serbisë dhe Kosovës, Vuçiç dhe Thaçi nisën të përhapin idenë e ndryshimit të kufijve. Ndërsa në SHBA ka mendime që nuk e përjashtojnë marrëveshjen për ndryshimin e kufijve, qeveria gjermane e konsideron atë tabu.

Një qëndrim që e kanë thuar se të gjitha partitë gjermane të përfaqësuara në Bundestag. Edhe eksperti i të Gjelbërve për Ballkanin, Emanuel Sarrazin, u shpreh në një deklaratë për shtyp me rastin e anoncimit të konferencës së Ballkanit Perëndimor më 29 prill në Berlin se, "kufijtë në Ballkanin Perëndimor duhet të jenë të paprekshëm". Sarrazin pret që Konferenca e Ballkanit Perëndimor të mos "humbasë në retorikë", por të dërgojë "mesazhe të qarta".

Përveç mosndryshimit të kufijve në Ballkan, Sarrazin kërkoi edhe çeljen e negociatave të BE-së me Maqedoninë e Veriut dhe Shqipërinë. Zëdhënësi i qeverisë, Seibert, i pyetur në konferencë për këto dy vende tha se kjo është kompetencë e Bashkimit Evropian dhe varet nga plotësimi i kushteve të para-para. Në rastin e Shqipërisë, ai tha se këtu hyn "funksionimi i institucioneve demokratike dhe i punës parlamentare". Ai u shpreh se vendimi për çeljen e negociatave do të varet nga progresraporti i Komisionit.

Te gjitha te rejat nga jeta e jipave

BLUE TOOTH

MADE IN ALBANIA

cdo të shtunë falas me

Opinion *i* Ditës

Koha për të folur shqip!?

Nga Shezai Rrokaj

(vijon nga faqja 1)

politika vazhdon me rënien tamtameve, e gozhduar në bunkerët e moskomunikimit për t'u dhënë zgjidhje problemeve konkrete të qytetarëve. Mazhoranca u bie vuvuzelave të fitoreve, kurse qytetarët janë të tejngopur prej politikës së premtiveve dhe skenave teatrale në media me regi të kontrolluar. Mandat pas mandati ata po mbeten të zhgënjyer, sepse duan një politikë konkrete me këmbë në tokë, të thjeshtë, të efektshme, që i zgjidh problemet e tyre, të cilat janë kaq bazike e të përditshme, teksa flitet në tym nga politika me ngarendje sloganesh të një realiteti imagjinar.

Politika deri tani ka synuar të sigurojë pushtet dhe jo të ndërtojë shtet që jep drejtësi të barabartë, mjekësi dhe arsimit të barabartë, shërbime publike të barabarta për të gjithë, votë të barabartë pavarësisht forcës, pushtetit e pozicionit. Pra, na duhet një shtet i së drejtës, jo më një pushtet që u jep 'të drejta' disave dhe ndëshkon të tjerët.


Ndaj këtë lloj politike qytetarët ose e kanë ndëshkuar me mospjesëmarrje në zgjedhje, ose kanë ikur jashtë. Mirëpo edhe kjo gjë nuk ua ka zgjidhur problemet e përditshme. Politika e sherrit dhe e konfliktit vazhdon, duke shpenzuar energji dhe duke u kthyer në një arenë loje tifozësh militantë, ku këta të fundit rreshtohen sa në njërin krah tek tjetri dhe kënaqen me dramën e tyre të radhës.

Ndaj është koha për t'i thënë ndal kësaj drame. Është koha për të folur shqip. Boll më me kinse fitore e me kinse sherre; boll më me grabitje të pronës, me pseudoreforma; me PPP-ra oligarkësh dhe me tendëra pa konkurrencë; boll më të deformuar, servilë ambasadorësh e kancelarish. Kur do të vendosim për të pasur më shumë vlerësim për veten?

Qytetarët kanë nevojë për një politikë të thjeshtë dhe të kuptueshme. Ajo duhet të jetë konkrete dhe bashkëpunuese për interesat e mëdha të vendit dhe të integritetit të tij në familjen evropiane. Pa premtime boshe, pa retorika, pa konflikte e tensione të panevojshme, ku shpenzohet energji negative e çlirohet toksinë.

Politika shqiptare ka qenë vrasësi më i madh i kohës së dobishme të shqiptarëve dhe bashkë me të edhe i ëndrrës së tyre për një integritet të shpejtë në BE. E mbërthyer fort në një kryeneçësi bajrakësh e kapëdarkësh, mes premtimesh e gjithfarë llojmotivish, prej ferrit deri të para-ja danteske; e ushqyer me tifozë fanatike e nën trysni të llojllojshme ajo i ngërdheshet qytetarit, e me shpirt në fyt e tërheq atë në greminën dramatike të humbjes së shpresës.

Mirëpo koha ikën, dhe përherë shqiptarët shpresëplotë për një jetë më të mirë mbeten të pashpresë, përherë në vagonin e fun-



dit, madje edhe më këmbë; mjaft syresh shumë të lodhur. Përherë i nisim punët nga e para. Nuk dinë të sosin një gjë deri në fund.

Teksa një pjesë rreket në deriret e pushtetit, e magjepsur prej tij, të tjerët ndihen të dëshpëruar, në pragun e një krize identiteti demokratik, i cili reflektohet në mungesën e një identiteti shtetëror funksional, që shpërfaqet në platforma zhvillimi me hope, të cilat nisnin sipas standardeve të perëndimit dhe përfundojnë sipas skenarëve të errët të mendësisë arkaikë të homo albanicus. Kurse qytetarët mbeten të zhytur në moçalin e kënetës politike që kutërbon.

A do ta fitojmë betejën me kohën apo si gjithmonë koha do të fitojë mbi ne? Beteja me kohën është betejë me veten, me evolucionin e qenies shqiptare në kohë. Beteja me kohën është betejë për një sistem demokratik për përcaktimin e vlerave të vërteta përkundërsht antiverlave, është betejë për ndërtimin e themeleve për zgjedhjen e sistemeve të përfaqësimit në të gjitha shtyllat e shtetit. Deri tani modelet qeverisëse nuk janë mbështetur mbi modele të drejta përfaqësimi. Deformimet në sistemin e përzgjedhjes, sipas vlerësimit vetëm të kryetarit, duke mënjeluar kriteret përzgjedhëse dhe strukturat; mandatat pa limit të krerëve të lartë të shtetit i kanë kthyer ata në 'Perëndi' apo në lojtarë pazaresh me burimet njerëzore, duke e asfiksuar meritokracinë dhe duke e zëvendësuar me militantizmin. Kjo është një energji negative që është prodhuar në trurin e deformuar të udhëheqësve autokratë dhe që ka sjellë si pasojë një mungesë sinergjike kolektive për të fituar kohën e humbur.

Por, a mund të bëhet Shqipëria prej shqiptarëve? Një pyetje me shumë enigma dhe shumë 'Si'. Sigurisht që do të bëhet, por vetëm atëherë kur çdo shqiptar do ta fitojë betejën me veten e tij,

me vetëdijen e tij, pra, betejën me kohën e cila, si për shumë demokraci funksionale, nuk duhet vazhdojë më të punojë mbrapsht për ne.

Qytetarët nuk kanë nevojë t'u premtohen kështjella në rërë. Për të fituar besimin e tyre, ata duan premtime realiste dhe serioze si, për shembull, ndarja e nëpunësit të shtetit prej atij të pushtetit dhe se ky i dyti nuk mund ta kthejë nëpunësin e shtetit në shërbëtor a frikaman ndaj pushtetit. A mund t'u themi qytetarëve se për shërbimet do të paguajnë vetëm taksën e shtetit dhe jo edhe pjesën e rryshfetit? A do ta kemi policim me uniformë të rregullt dhe jo tërë njolla e të zhubravitur, i cili para se të merret me opozitën për të garantuar pushtetin e mazhorancës, në radhë të parë të ruajë aeroportin nga vjedhjet e turpshme për një shtet, si kjo që ndodhi këto ditë. Po doganierin, a do ta kemi korrekt me ligjet e shtetit, për të mos lejuar maunet e pushtetit që të kalojnë pa doganë dhe maunet e biznesmenëve të tjerë me doganë, apo duke ua bërë me shenjë të kalojnë nga zyrat e pushtetit, pastaj të paraqiten në doganë? Po për të marrë një licencë, një lejë ndërtimi, a duhet të paguhet përsëri rryshfet?

Po diplomatit ynë, a do ta përfaqësojë me kremari shtetin e tij, apo do ta përdorë statusin e tij për bizneset e veta? Cila është fytyra e shtetit që kemi krijuar nëpër kancelaritë e shteteve dhe sa diplomatit ynë është në pritshmërinë e statusit të tij?

Po togat e zeza, a do të çlirohen nga trysنيا dhe nga kapja e pushtetit, i cili po i kap një e nga një prokurorinë, gjykatat? A do të heqim dorë nga vendosja e njerëzve 'besnikë' të partisë në nivelet larta të gjyqësorisht?

nismave të mira qytetare?

A do të ketë standarde të njëjta për arsimin publik e privat? Si po përballat diploma me kërkesën e zhvillimit të vendit? Si do të rikthehet cilësia në shkollë dhe si do të përputhet strategjia e formimit me strategjinë e zhvillimit për t'u bërë funksionale në një strategji punësimi? A do të investojmë për arsimin 5% të PBB-së, si vendet e tjera, apo do të bëjmë sikur, duke u zhytur në platforma shumëfaqëshe të pafytyrshme? Si do të përfshihen universitetet në projektet zhvillimore të territorit për të gjenurur fonde? A do të jenë universitetet partnerë të qeverisë për zhvillimin kombëtar apo qeveria do të vazhdojë si dikur t'i konsiderojë si institucione vasale? Si do të zhvillohet arsimi profesional për t'u përgjigjur diversitetit të tregut të zanaveve?

Është koha për të folur shqip me qytetarët. Shqip për një plan kombëtar edhe për luftën kundër krimi dhe drogës që po shkon deri në shkolla.

Të flasim shqip dhe për sistemin fiskal, për taksën e sheshtë apo progresive, por edhe se si do të mënjanohet informaliteti, evazioni fiskal, në mënyrë që shteti të jetë funksional për të gjithë. Si mund të vazhdohet ende me idenë se qeveria është generator vendesh pune kur marrëdhënia e punës krijohet në treg dhe tregu është privat? Flitet për reforma në sektorë të ndryshëm prodhues, për gjenerim të vendeve të punës, por nuk flitet qartë për një sistem që të lidhë në mënyrë shpronçionale sistemin e taksimit me sistemin e punësimit (rritjet ose uljet taksës nëse fitimin e (ose nuk e) konverton në zhvillim kapitali e vende pune).

Është pra, koha për të folur shqip mes nesh. Këtë duan të bëjnë. T'u themi shqip qytetarëve se së bashku mund t'ia dalim të ngrihem si feniksi nga hiri vet. Por, për këtë ta fillojmë duke folur shqip. Sakaq, "fugit irremparabile tempo!".

HOROSKOPI

DASHI
Të lindurit e kësaj shenje nuk duhet t'i gjykojnë të tjerët nga pamja e jashtme. Ka gjasa që pas një personi të thjeshtë në dukje, të jetë dikush me shumë autoritet ose mund të jetë një person mjaft i përsh-tatshëm për të qenë partneri juaj. Është e rëndësishme të mbani nën kontroll emoci-onet.

DEMI
Demët nuk duhet të mendojnë sot për të ardhmen. Do të jetë e pamundur sot të parashikoni rezultatit e kësaj dite. Mund të nisni një histori të re dashurie ose t'i thoni lamtumirë partnerit/partneres suaj. Qen-droni të qetë pavarësisht gjithçkaje.

BINJAKET
Binjakët do të përjetojnë emocione mjaft të këndshme këtë të shtunë. Mund të bëni udhëtime në vende ku nuk keni qenë më parë ose mund të takoni një person mjaft të veçantë. Në mbrëmje do të keni dëshirë të ndryshoni arredimin e shtëpisë. Dikush mund t'ju mbushë me optimizëm.

GAFORJA
Gaforret do të marrin informacione të shum-ta këtë të premtë. Në mënyrë që të mos humbisni në bisedat e dikujt, përqijoni të qetësheni psikologjikisht. Nuk rekoman-dohet të analizoni menjëherë informacio-net, pasi duhet një kohë e caktuar për të kuptuar situatën e krijuar.

LUANI
Disa Luanë do të ndihen të palumtur me veten e tyre. Ndoshta emocione të tilla do t'ju sjellin një ndjesi të pakëndshme, si në jetën personale ashtu edhe atë profesio-nale. Për ta shmangur këtë gjendje, bëni mirë të planifikoni disa ditë pushime.

VIRGJERESHA
Të lindurit e kësaj shenje rrezikojnë të har-rojnë diçka të rëndësishme. Ndoshta bëhet fjalë për një premtim ndaj gjysmës suaj të dytë, fëmijës ose një të moshuarit në famil-jë. Gjithashtu, do të keni probleme me finan-cat, duke bërë që të mos blini diçka që kishtat kohë që e mendoni.

PESHORJA
Peshoret ka gjasa të trishtohen për shkak të një lajmi të papritur. Kjo mund të ketë lidhje me punën, çfarë mund të ndikojë të finacat. Mund të dëni nga kjo situatë vetëm nëse u ndihmon një mik u juaj. Sa i përket ndjenjave, do të përjetoni emocione mjaft pozitive.

AKREPI
Disa Akrepë do ta kalojnë pjesën më të madhe të ditës me punët e shpë-tisë. Pasdite mund të gjeni kohë për veten tuaj. Do të ishte mirë nëse dini jashtë qytetit. Nuk është dita e duhur për çdo gjë që ka lidhje me marrëdhënien tuaj të dashurisë.

SHIGJETARI
Shigjetarët mund t'ju mbajnë një përgjegjë-si të madhe sot. Ka gjasa të kujdeseni për një person të sëmurrë këtë të shtunë. Megjithatë, përqijoni t'i merrni gjërat me lehtësi. Në mbrëmje mund të merrni një dhu-ratë ose një lajm mjaft të mirë.

BRICJAPI
Bricjapët do të dëgjojnë vetëm veten e tyre sot. Arsyetja për këtë do të jetë fakti që mund të keni besim të tepërt në veten. Mund të merrni rolin e liderit sot në familje ose në marrëdhënie me një grup personash. Megjithatë, merrni parasysh edhe rrezikun e mundshëm.

UJORI
Ujorët duhet të frenohen nga negociatat e lodhsh-me dhe udhëtimet e gjata. T'rupi juaj do të kërkojë pushim të plotë. Mendojeni se si të orga-nizoni kohën e lirë në shtëpi, në mënyrë që të kaloni sa më shumë momente interesante. Nga ana tjetër, ju mund të forni miqit tuaj një ngjash- ose të organizoni një darkë romantike.

PESHQIT
Peshqit mund të fyejnë dikë sot. Për të shmangur këtë parashikim, tregohuni të kujdeshëm dhe me takt. Në përgjithësi, këtë të shtunë do të kaloni momente të këndshme. Është koha e duhur për të eks-perimentuar në fusha të cilat nuk i njihni mirë.

BARDHEBLUTË



Tirana nuk po kalon një moment aspak të mirë si në rezultate ashtu edhe në aspektin psikologjik, me bardheblutë që po ndajnë gjithmonë e më shumë presionin e Kastriotit, i cili ka arritur ta ngushtojë diferencën me 3 pikë me ekipin e Ardian Memës. Kryeqytetasit suksesin e fundit në kampionat e kishin regjistruar më 22 shkurt me fitoren ndaj Skënderbeut, ndërsa deri në

Mbijetesa e Tiranës, prova e parë e zjarrit qehet Teuta

fitoren 3-0 në tavolinë ndaj Kamzës, nuk kishin mundur të siguronin 3 pikët prej një muaji e gjysmë. Kjo, por edhe akuzat e trajnerit Mema për lojërë tavolinash nga ekipet e tjera, kanë rritur shumë presionin tek Tirana, që ndaj Teutës në Durres luan provën e parë të

zjarrit, pasi bregdetarët vijnë nga eliminimi në Kupë dhe dy humbje radhazi në kampionat. Më pas një tjetër sfidë delikate, ajo ndaj Kukësit pretendent për titull, për të shkuar të derbi i parë i mbijetesës në fazën e fundit, ai ndaj Luftëtarit. Në javën e 32-të Tirana pret

Skënderbeun për të zhvilluar më pas derbin e madh të kryeqytetit ndaj Dinamos. Java e 34-ët rezervon derbin e dytë të mbijetesës, përballjen ndaj Kastriotit. Dy sfidat e fundit, ajo ndaj Laçit dhe Flamurtarit janë, gjithashtu, delikate, por tek Tirana diçka e kanë të qartë: mbijetesën nuk duhet lënë për ndeshjen e fundit, pasi kujtimet e së shkuarës së afërt janë të hidhura.

Nga Shkodra, kreu i FSHF-së rithekson se emërimi i timonierit të Kombëtares do të bëhet këtë muaj

Jeton Selimi



Situata që ka mbërthyer futbollin shqiptar këtë periudhë nuk është aspak ajo që të gjithë shpresonin. Në kulmin e sezonin, futbollit shqiptar u paralizua, dhuna ndaj gjyqtarit Hamiti solli një efekt domino të pashembullt, bojkot në rang kombëtar nga arbitrat. Dënim i ekzemplar i Kamzës nuk pati asnjë efekt pasi dhuna në stadiume erdhi në forma të ndryshme, me presidente, futbollistë, staf drejtues etj. të cilët bënë "pis" edhe një herë produktin e tyre.

Jo vetëm dhunë, por ky sezon është jo pak i çuditshëm ku vetë aktorët shprehen se futbollit nuk po luhet më në fushë, por në tavolina. Armand Duka nuk dëshiron as të flasë me emra të përveçëm e as të ndalet në episode të veçantë, e rëndësishme për të është që aktorët të përpigën të arrijnë objektivat e tyre në fushën e lojës: "Futbolli është një

Duka "driblon" dhunën dhe trajnerin e ri kuqezi

Asnjë fjalë për akuzat e futbollit të tavolinave



garë me emocione dhe gjithsecili duhet të frenojë dhe komandojë ato pozitivisht. Duhet që çdo individ t'i shfrytëzojë për zhvillimin e kësaj loje dhe jo për të kundërtën. Është fundi i kampionatit dhe të gjithë duan të marrin maksimumin, por harrojnë që maksimumi merret në fushën e lojës dhe duhet sa më tepër angazhim brenda saj për ta finalizuar me sukses sezonin. Kjo nuk vlen vetëm për Superiore, por të gjitha kampionatet që organizon FSHF", -u shpreh Duka

TRAJNERI I KOMBËTARES

Fill pasi shkarkojë Kristian Panuçin, Armand Duka ka nisur një fushatë

të vërtetë për të gjetur pasesin e italianit. Negociata, oferta, kërkesa, shumë takime për ti dhuruar Kombëtares një timonier të ri. Presidenti i FSHF po shfrytëzon statusin e tij si personi i vetëm përgjegjës për të përzgjedhur e trajnerin. Nga Shkodra, Duka sërish nuk jep një emër konkret por shprehet i bindur se trajneri dhe stafi i ri teknik do të zgjidhen javën e ardhshme: "Kam thënë që në prill do të emërohet. Jemi në 12 prill, muaj nuk ka mbaruar. Javës tjetër besoj se do të kemi caktuar jo vetëm trajnerin, por krejt stafin teknik kuqezi. Ata do të jenë gati për të përgatitur ndeshjen e radhës", u shpreh Duka.

NDIZET MERKATOJA

Dormundi jep 33 mln për Neres, Ajaksi e refuzon

David Neres është një nga talentet e shumtë të Ajaksit të Amsterdambit, me sulmuesin që edhe ndaj Juventusit shfaqti një formë të jashtëzakonshme duke realizuar një gol të shkëlqyer në sfidën e vlefshme për çerekfinalen e Ligës së Kampionëve. Sipas asaj që raporton "Telegraph", Borussia e Dortmundit është vënë menjëherë në lëvizje për ta bërë të sajën 22-vjeçarin e "harkëtarëve", madje duke paraqitur një ofertë zyrtare në zyrat e klubit holandez. "Telegraf" bën me dije se oferta e paraqitur nga gjermanët është 33 milionë euro, por Ajaksi nuk e ka marrë në konsideratë këtë shumë, duke ua kthyer pas ofertën verdhëbluve. Gjithsesi Dortmundi nuk ka hequr dorë dhe në ditët në vijim do të paraqesë një tjetër ofertë.



REAL MADRIDI

"Marca" zbulon: Hazard, ylli i vetëm në merkato


Të gjithë ata tifozë që po prisnin një merkato galaktike të Real Madridit, mund të kenë mbetur të zhgënjyer kur kanë lexuar numrin e sotëm të gazetës "Marca", e cila sjell disa prapaska në reja në lidhje me atë që pritet të bëjë klubi spanjoll në verë. Sipas "Marca"-s, Zinedin Zidane dëshiron në skuadër vetëm Eden Hazard, i cili do të ishte dhe ylli i vetëm që do t'u bashkohen spanjollëve në verë. Trajneri francez e pëlqen jashtëzakonisht sulmuesin Brazilian Vinicius dhe nuk dëshiron në asnjë mënyrë që të pengojë zhvillimin e talentit Brazilian. Në repartet e tjera të skuadrës nuk përjashtohen përforsime të tjera, por sa i takon fazën ofensive, belgu i Çelsit qenka emri i vetëm që Zizu i ka dhënë Florentino Perezit.




BAJERNI I MYNIHUT

Sherri mes Levas dhe Koman, Kovaç: Asnjë ndëshkim

Lajmi i publikuar nga "Bild" për sherrin e ndodhur në stërvitje me sulmuesit polak Robert Lewandovski dhe anësorit francez Kingsli Koman, ka tronditur jo pak tifozët bavarezë dhe opinionin në Gjermani, që të Bayern Mynih kanë parë gjithnjë klubin ideal. Ndaj bavarezët nuk e kanë kaluar në heshtje këtë temë, me trajnerin kroat Niko Kovaç, që ka folur rreth argumentit në fjalë duke habitur jo pak gazetarët, që natyrisht prisnin diçka tjetër: "Pola me te dy pas stërvitjes, ata shfaqen qetërdhje për sjelljen e tyre dhe i kërkuam falje njëri-tjetrit. Nuk do të ketë ndëshkim për asnjërin, çështja është zgjidhur dhe çdo gjë është në rregull. Janë gjëra që ndodhin në stërvitje", - tha ndër të tjera Kovaç.



Fjalëkryqi (1)



HORIZONTAL

- Ferguson trainer.
- Grand Prix
- Është stacion beduinësh.
- Një artikull jo për vejetarian
- Kufti i vjen... di të bëjë.
- Kaçaturian kompozitor
- Logot pa kujfi
- Parashtesë për vetë.
- Aktorja protagoniste e Vertigo.
- Ndezur në aparaturë.
- Është si telefilm.
- Ai i shtatë është kinemaja.
- Është me shumë se kërkesë.
- Cristiano bomber te Real Madrid.
- Teket e grave.
- Në krye të masave.
- Shkon goja... nga nepsi.

- Duken të gjata ato të pritjes.
- Gjysmë bataku.
- Është për medaljen e parë
- Është kujdesi i babait.
- ... Maiden që këndojnë.
- Një "bombë" tenistike.
- Fillojnë mykjen
- Janë këngëtarët si Jose Carreras
- Është këngë e kënduar nga komiku
- Lumë në Francë.
- Piktori i Ura e Narnit.
- Kapen në kujfi

VERTIKAL

- Në hyrje të ambientit
- Neeson aktor.
- Ente Sociale Rumune.
- Ajo e zezë nënkpton arbitrin.
- Kufizojnë stacionin.
- Tremb fëmijët.
- Jepet për t'u marrë.
- Qytet japonez.
- Është pemë
- Janë tallësit.
- Roberto trainer italian.
- Freni këngëtare lirike.
- Gjysmë totale.
- Një si divan.
- Tipare pa zë
- Ulet në dhomën e lartë.
- Moore aktor.
- Qe bomber brazilian.
- Ishte shpërthimi i Little Boy.
- Carolina, e bukura e Belle epoqe.
- Mbarojnë fare
- Pullman aktor.
- Është thellimi
- Meg aktore.
- Ndërmarrje Industriale Rajonale.
- Një lidhëz.
- Kaluar në krye.
- Fundi i Turandot.


Fjalëkryqi (2)

HORIZONTAL


- Mund të hidhet te kiromanti
- Teket e kafes.
- D'Istria e Helena Gjikhës
- Smith filozof.
- Kuke regjisor
- Një pjesë e minoritetit.
- Modulli i Neil Armstrong.
- Mund të jenë qitjeje.
- Markë pistolette.
- Mbyllin fushatat.
- Është dorëzim.
- Është detar.
- Fillojë ilustrimet.
- Është hon.
- Diftong në duel
- Një pjesë e rifillimit.
- Një që kuron karrien.
- Nganjëherë duhen vënë mbi i.

VERTIKAL


- E egër dhe e fortë.
- Janë thënie e famshme.
- Janë trupa qiellore të tillë.
- Inicialet e Stone regjisor
- Smith filozof.
- Në krye të trupave.
- Mund të jenë diskografike.
- Është e zakonshme për pushime
- Skuađar greke.
- Bel i Maupassant.
- Është thesar.
- E famshme ajo maqedonase.
- Një zakon.
- Bëjnë alarm me ar
- Inicialet e Mallé regjisor
- Mund të jetë telefonike
- Ka dy faqe
- Mund të jetë një cutter.
- Në mes të dhomës.
- Mbahet me bateri.
- Përfshijnë edhe Haitin.
- Denis i enëve me presion.
- Pagutën për shërbime.
- Janë ufo.
- Ekstreme në tunel.
- Një atentator vetëvrasës.
- Markë cigaresh.
- Arrihet duke mundur.
- Jonathan, regjisor i Heshtja e qengjave.
- Është aparati me zorrë.
- Pak servilizëm.
- Kështu e ka syrin vigjilent.
- Fatih trainer turk.
- ... Nostra me mafiozët.
- Mbyllin punimet.
- Ai i shenjtë është papa.
- Kufizojnë në teknik.
- Fillojnë panikun.
- Fund tuneli.
- Në krye të armatës.



Gjeni ndryshimin



Dy figurat kanë ndryshime nga njëra-tjetra



Përgjigja, ja cilat janë ndryshimet e figurave

SUDOKU

1	5		2					
	7	3				6		
							9	
7						1	3	
			7					
4			1			8	5	
				7	2			
				3	5			
2				6	8			

Plotësoni vendet bosh në mënyrë që çdo kolonë të ketë numrat nga 1-9

Përgjigje e sudokut të numrit të kaluar

1	8	2	3	4	5	7	9	6
9	3	4	8	6	7	5	1	2
5	6	7	9	1	2	8	3	4
6	1	5	7	8	4	9	2	3
8	2	3	5	9	6	1	4	7
7	4	9	1	2	3	6	8	5
2	5	8	6	3	9	4	7	1
3	7	1	4	5	8	2	6	9
4	9	6	2	7	1	3	5	8

Argëtim filozofik

- Rruga drejt lumturisë nuk është e drejtë ... Ka shumë kthesa të quajtura "gabime".

- Burgu më i madh në të cilin njerëzit jetojnë është frika se çfarë mendojnë të tjerët !!!

- I lumtur është ai njeri që di se çfarë të mbajë mend nga e kaluara, çfarë të shijojë në të tashmen, dhe çfarë të planifikojë për të ardhmen.

KRIPTOSKEME

KRIPTOSKEME
Përgjigja e numrit të djeshëm

4	9	3		11	5	9	6	11	1	4	3
12	16	15	17	6	11	15	4	12	2		
6		1	4	12	6	11	5	18	11	2	9
17	18		5	4	12	6	1	4	14	2	3
2		1	7	3	2	9	7	9	2	3	
14	4	1	7	9	4	3	7	9	2	3	
18	4		6	9	8		4	12	7	9	
9	2	12	2	4		12	3	9	2	18	
14	8	2	3	5	6	6	6	6	16	15	
5	K	4	12	3	11	2	5		3	6	12
15	3	6		1	2	3	4		3	2	11
17		9	9	15	16	4		4	9	3	2

T	R	I	M	S	M	M	A	S	A	T
A	R	B	E	E	M	L	I	M	A	
K	D	E	L	E	G	A	T	E	T	L
M	I	T	O	M	A	N	E	T	D	E
K	O	M	U	N	I	T	E	T	E	T
O	P	E	R	A	T	O	R	E	T	F
M	N	I	E	N	O	G	A			
P	S	N	N	I	K	M	A	L	L	I
A	M	I	A	N	T	K	M	A	L	O
N	O	T	E	K	I	P	O	R	E	
I	T	N	E	T	I	L	E	N	I	E
A	L	I	B	I	S	I	R	T	A	R

- Pengesa më e madhe është frika ...
- Mërzitja është një humbje kohe ...
- asgjë nuk ndryshon, me përjashtim ngatërrimin e mendimeve dhe vjedhjen e lumturisë tuaj !!!
- gabimi më i madh është braktisja !!!

Thënie të mençura

PËRGJIGJET E FJALËKRYQJEVE TË NUMRIT TË KALUAR

FJALËKRYQI (1)

F	A	U	T	O	P	O	R	T	R	E	T
A	S	T	R	I	D	K	O	R	E	K	
R	H	T	M	A	R	A	T	O	N	A	
A	K	M	A	R	A	T	O	N	A	A	P
D	O	N	A	T	O	R	E	T	R	I	T
P	I	R	A	T	I	I	E	T	C		
K	I	N	E	M	A	T	E	T	E	R	R
R	I	T	A	A	M	E	T	R	A	T	
I	V	E	N	U	S	B	E	V	E		
I	O	E	R	P	E	T	A	L	E	T	
I	D	A	T	I	K	A	E	M	I	L	E
M	A	T	A	M	I	N	A	R	E	T	T

FJALËKRYQI (2)

F	I	E	R	V	M	A	R	A	T	B
E	R	A	M	E	Z	O	N	E	T	M
R	E	M	I	R	E	L	O	M	E	
T	N	A	K	O	L	O	N	I	T	E
T	E	R	S	E	R	T	E	S	I	E
A	T	E	L	E	G	O	N	I	O	P
T	R	E	N	T	V	A	N	E	N	
E	M	R	A	T	Z	K	O	M	E	T
T	I	T	M	A	N	E	T	M	A	T
I	A	G	R	N	A	T	E	J	L	
K	D	R	O	M	A	N	R	A	E	K
E	U	R	E	K	A	A	T	O	M	T

